FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 134

Tiranë – E enjte, 25 qershor 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 55/2026, datë 4.6.2026	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Polonisë për sigurimet shoqërore.....	12269
Dekret i Presidentit nr. 358, datë 23.6.2026	Për shpallje ligji.....	12315
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 653, datë 18.6.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë.....	12315
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 654, datë 19.6.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Hungarisë.....	12317
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 10.3.2026	Çështja Manjani kundër Shqipërisë *(kërkesa nr. 32283/23*).....	12319
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 2053, datë 22.4.2026	Për shpalljen të vdekur të shtetasit Petrit Çela.....	12334
	Kërkesë për shpalljen e vdekjes së shtetasit Skënder Ajazi.....	12334

LIGJ
Nr. 55/2026

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË POLONISË PËR SIGURIMET SHOQËRORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Polonisë për sigurimet shoqërore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.6.2026.

Shpallur me dekretin nr. 358, datë 23.6.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

MARRËVESHJE

NDËRMJET

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

REPUBLIKËS SË POLONISË

PËR SIGURIMET SHOQËRORE

Republika e Shqipërisë,
dhe
Republika e Polonisë,

në vijim të referuara si "Palët Kontraktuese",

duke dashur të rregullojnë marrëdhëniet e ndërsjella midis dy Shteteve në fushën e sigurimeve shoqërore, kanë rënë dakord si më poshtë:

PJESA I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizimet

1. Në këtë Marrëveshje, termat e mëposhtëm kanë kuptim:
   1) "legjislacioni" - ligjet dhe aktet e tjera ligjore të secilës Palë Kontraktuese mbi fushën lëndore të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje të përmendur në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje;
   2) "autoriteti kompetent" - Ministri ose Ministrat kompetent për sigurimet shoqërore;
   3) "institucion kompetent" - institucioni përgjegjës për zbatimin e legjislacionit;
   4) "organ ndërlidhës" - institucioni që ofron koordinim dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve të Palëve Kontraktuese për qëllimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje;
   5) "vendbanimi" - vendbanimi i përhershëm në përputhje me dispozitat ligjore të secilës Palë Kontraktuese;
   6) "vendqëndrimi" - vendqëndrimi i përkohshëm në përputhje me dispozitat ligjore të secilës Palë Kontraktuese;
   7) "periudha e sigurimit" - periudhat e kontributeve, periudhat e punësimit ose të vetëpunësimit, të përcaktuara ose të njohura si të tilla nga legjislacioni sipas të cilit ato janë realizuar dhe periudha ekuivalente në përputhje me legjislacionin e një Pale Kontraktuese;
   8) "person i siguruar" - një person i cili është ose ka qenë i siguruar në përputhje me legjislacionin e një Pale Kontraktuese;
   9) "përfitimet" - përfitimet në para duke përfshirë rritjet, shtesat dhe subvencionet të parashikuara në nenin 2, paragrafi 1 i kësaj Marrëveshjeje, sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese;
   10) "transmetim elektronik" - shkëmbimi i të dhënave duke përdorur çdo lloj mjeti të transmetimit elektronik.
2. Termat e tjerë të përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimin që u jepet atyre në legjislacionin e secilës Palë Kontraktuese.

Neni 2
Fusha lëndore e zbatimit

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për legjislacionin në lidhje me:
   1) për Republikën e Shqipërisë - për përfitimet e mëposhtme nga sistemi i sigurimeve shoqërore:
      (1) pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe pensionet familjare;
      (2) përfitimet në rast sëmundjeje
      (3) përfitimet e barrëlindjes;
      (4) përfitimet në rastet e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;
      (5) pagesat e papunësisë.
   2) për Republikën e Polonisë - për sigurimin e detyrueshëm dhe përfitimet e mëposhtme nga sigurimet shoqërore:
      (1)pagesat e papunësisë, si dhe nga sigurimi i përgjithshëm shoqëror dhe nga sigurimi shoqëror për fermerët,

(2) përfitimet për sëmundje dhe barrëlindje,
(3) pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe familjar,
(4) pagesa të njëhershme, pagesat dhe pensionet e invaliditetit për shkak të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale,
(5) pagesa për vdekje.

2. Kjo Marrëveshje zbatohet gjithashtu për të gjitha ligjet dhe dispozitat e tjera ligjore që ndryshojnë ose plotësojnë legjislacionin.

3. Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për ligjet ose dispozitat e tjera ligjore që e zgjerojnë legjislacionin ekzistues të një Pale Kontraktuese për kategori të reja përfituesish, nëse autoriteti kompetent i asaj Pale Kontraktuese njofton autoritetin kompetent të Palës tjetër Kontraktuese brenda gjashtë muajve nga data e publikimit të këtyre ligjeve të reja ose dispozitave të tjera ligjore që nuk parashikohet një zgjerim i tillë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3
Fusha e zbatimit personal

Kjo Marrëveshje zbatohet për:
1) personat që janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit të njërës ose të të dyja Palëve Kontraktuese;
2) personat e tjerë, kur të drejtat e tyre rrjedhin nga të drejtat e personave të specifikuar në paragrafin 1.

Neni 4
Trajtimi i barabartë

Përveçse nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, personat ndaj të cilëve zbatohen dispozitat e kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohen detyrimeve dhe gëzojnë të drejtat e parashikuara nga legjislacioni i Palës tjetër Kontraktuese në të njëjtat kushte si shtetasit e asaj Pale Kontraktuese.

Neni 5
Eksporti i përfitimeve

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, përfitimet e fituara sipas legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese nuk reduktohen, pezullohen, revokohen ose anulohen për shkak se personi përfitues ka të drejtën e banimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen:
1) në Republikën e Shqipërisë: për përfitime, kompensime ose shtesa të natyrës jokontributive;
2) në Republikën e Polonisë për: pagesat e papunësisë dhe përfitimet e dhëna sipas procedurave të veçanta ose në raste të jashtëzakonshme.

PJESA II
LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

Neni 6
Dispozita të përgjithshme

Nëse nuk parashikohet ndryshe në nenet 7 dhe 8 të kësaj Marrëveshjeje:

1) personi i punësuar në territorin e një Pale Kontraktuese, në lidhje me atë punësim, i nënshtrohet vetëm legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese;
2) personi i vetëpunësuar në territorin e një Pale Kontraktuese, në lidhje me atë punë, i nënshtrohet vetëm legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese.

Neni 7
Dispozita të veçanta

1. Kur një person i punësuar nga një punëdhënës, zyra e regjistruar e të cilit ndodhet në territorin e njërës Palë Kontraktuese, dërgohet në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për të punuar atje për atë punëdhënës, ai person i nënshtrohet legjislacionit të Palës së parë Kontraktuese, me kusht që periudha e parashikuar e punës të mos jetë më e gjatë se 24 muaj dhe ai të mos jetë dërguar për të zëvendësuar një person tjetër periudha e transferimit të të cilit ka përfunduar.

2. Një person i vetëpunësuar që ushtron veprimtarinë e tij në territorin e njërës Palë Kontraktuese, i cili e kryen përkohësisht të njëjtën veprimtari si i vetëpunësuar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, i nënshtrohet legjislacionit të Palës së parë Kontraktuese për periudhën e ushtrimit të kësaj veprimtarie, por jo më shumë se 24 muaj.

3. Nëse periudha e kryerjes së punës për të cilën bëhet fjalë në paragrafin 1, ose periudha e kryerjes së aktivitetit për të cilin bëhet fjalë në paragrafin 2, zgjatet mbi 24 muaj, vazhdon të zbatohet legjislacioni i Palës së parë Kontraktuese për një periudhë tjetër që nuk i kalon 24 muaj, me kusht që Autoriteti Kompetent i Palës së dytë Kontraktuese ose institucioni i autorizuar nga ky organ ta miratojë këtë kërkesë.

4. Personeli i një ndërmarrjeje transporti që operon me shërbime transporti ndërkombëtar për persona ose mallra me transport hekurudhor, rrugor, ajror ose ujor të brendshme në territoret e të dy Palëve Kontraktuese, i nënshtrohet legjislacionit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës zyra e regjistruar e ndërmarrjes është vendosur.

5. Personi i punësuar në bordin e një anijeje që mban flamurin e një Pale Kontraktuese i nënshtrohet legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese.

6. Nëpunësit civilë dhe personat e trajtuar si të tillë i nënshtrohen legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese, administrata e së cilës i punëson ata.

7. Anëtarët e personelit të misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore i nënshtrohen dispozitave të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike

e nënshkruar në Vjenë më 18 Prill 1961 dhe Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore e nënshkruar në Vjenë më 24 Prill 1963.

Neni 8
Përjashtimet

Autoritetet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese ose institucionet e përcaktuara prej tyre, me marrëveshje të përbashkët, mund të vendosin përjashtime nga dispozitat e neneve 6 dhe 7 paragrafët 1 deri në 6 të Marrëveshjes në lidhje me çdo individ ose grup, në interes të tyre.

PJESA III
DISPOZITAT LIDHUR ME PËRFITIMET

KAPITULLI 1
Pagesa e papunësisë

Neni 9
Përcaktimi i të drejtave

1. Periudhat e sigurimit të realizuara sipas legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese merren parasysh kur është e nevojshme, me kusht që të mos mbivendosen, për përcaktimin e së drejtës për pagesën e papunësisë sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, nëse personi i papunë ka periudha sigurimi në përputhje me legjislacionin e Palës së fundit Kontraktuese menjëherë përpara se të bëhet i papunë.

2. Periudha e marrjes së përfitimit të papunësisë do të shkurtohet me periudhën e pagesës së papunësisë të marrë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese brenda 12 muajve të fundit përpara datës së regjistrimit si person i papunë.

KAPITULLI 2
Përfitimet për shkak të sëmundjes dhe të barrëlindjes

Neni 10
Bashkimi i periudhave të sigurimit

Periudhat e sigurimit të realizuara në përputhje me legjislacionin e secilës Palë Kontraktuese merren parasysh, kur është e nevojshme për përcaktimin e së drejtës për përfitime, shumën dhe periudhën e përfitimit, me kusht që ato të mos mbivendosen.

Neni 11
Përfitimet

1. Përfitimet për sëmundje dhe barrëlindje do të caktohen dhe paguhen nga institucioni kompetent i Palës Kontraktuese, legjislacionit të së cilës i ishte nënshtruar personi i siguruar në momentin e fitimit të së drejtës për këto

përfitime, edhe nëse personi i siguruar e ka vendqëndrimin në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Përfitimet për sëmundje dhe barrëlindje i paguhen drejtpërdrejt personit që i lind e drejta nga institucioni kompetent, në përputhje me nenin 28 të kësaj Marrëveshjeje.

KAPITULLI 3
Pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe familjar

Neni 12
Bashkimi i periudhave të sigurimit

1. Kur legjislacioni i njërës Palë Kontraktuese e kushtëzon lindjen, ruajtjen ose rikthimin e së drejtës për pension me realizimin e një periudhe të caktuar sigurimi, institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese merr parasysh, kur është e nevojshme, periudhat e sigurimit të realizuara sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, sikur të ishin periudha sigurimi të realizuara sipas legjislacionit të zbatuar nga ai institucion, me kusht që këto periudha të mos mbivendosen.

2. Kur legjislacioni i njërës Palë Kontraktuese e kushtëzon lindjen e së drejtës për pension me plotësimin e periudhave të caktuara të sigurimit në një profesion që i nënshtrohet sigurimit sipas një skeme të veçantë, ose në një punësim specifik, atëherë periudhat e sigurimit të realizuara në atë profesion ose punësim sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, merren parasysh gjatë përcaktimit të së drejtës për pension.

3. Kur, duke marrë parasysh bashkimin e periudhave të përmendura në paragrafin 1, personi i siguruar nuk e fiton të drejtën për pension, institucioni kompetent i Palës Kontraktuese merr parasysh periudhën e sigurimit të realizuar në një shtet të tretë, me të cilin të dyja palët kontraktuese janë të lidhura me marrëveshje ndërkombëtare që parashikon bashkimin e periudhave të sigurimit.

Neni 13
Periudhat e sigurimit më të shkurtra se 12 muaj

1. Kur periudhat e sigurimit të realizuara sipas legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese janë më të shkurtra se 12 muaj dhe sipas legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese personi në fjalë nuk e fiton të drejtën për pension, institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese nuk i cakton pension.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, periudhat e sigurimit më të shkurtra se 12 muaj të realizuara sipas legjislacionit të secilës Palë Kontraktuese, merren parasysh nga institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese ku e drejta për pension lind pas bashkimit të këtyre periudhave.

Neni 14
Asimilimi i fakteve dhe ngjarjeve

Faktet dhe ngjarjet që ndikojnë në marrjen, pezullimin ose masën e pensionit, që kanë ndodhur në territorin e njërës Palë Kontraktuese merren parasysh sikur të kishin ndodhur në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 15
Pensionet pa bashkim të periudhave të sigurimit

Kur një person plotëson kushtet e nevojshme për të fituar të drejtën e pensionit sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese pa marrë parasysh periudhat e sigurimit të realizuara sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, institucioni kompetent i Palës së parë Kontraktuese përcakton të drejtën për pension dhe llogarit shumën e tij vetëm në bazë të periudhave të sigurimit të realizuara sipas legjislacionit që ai zbaton.

Neni 16
Pensionet me bashkim të periudhave të sigurimit

1. Kur në përputhje me legjislacionin e njërës prej Palëve Kontraktuese, e drejta për pension fitohet vetëm pas zbatimit të dispozitave të nenit 12 të kësaj Marrëveshjeje, institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese e llogarit pensionin në mënyrën e mëposhtme:
   1) llogarit shumën teorike të pensionit që i takon përfituesit, sikur të gjitha periudhat e sigurimit të ishin kryer sipas legjislacionit që ai zbaton;
   2) në bazë të shumës teorike të përmendur në paragrafin 1, përcaktohet shuma reale e pensionit në bazë të raportit të periudhave të sigurimit të realizuara sipas legjislacionit që zbaton, me shumën e të gjitha periudhave të sigurimit të realizuara.
   3) nëse kohëzgjatja e periudhave të sigurimit të bashkuara sipas nenit 12 të kësaj Marrëveshjeje, e kalon maksimumin e periudhës së sigurimit të nevojshme për përfitimin e pensionit të plotë sipas legjislacionit të zbatuar, institucioni kompetent përcakton masën e përfitimit si proporcion të periudhave të sigurimit të realizuara sipas këtij legjislacioni në raport me periudhën maksimale të sigurimit për pension të plotë sipas legjislacionit të kësaj Pale Kontraktuese.

2. Gjatë përcaktimit të bazës së vlerësueshme për pension, institucioni kompetent i secilës Palë Kontraktuese merr parasysh vetëm pagat e realizuara sipas legjislacionit të zbatuar nga ai institucion si dhe kontributet e mbledhura sipas atij legjislacioni.

KAPITULLI 4
Aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale

Neni 17
E drejta për përfitime

1. E drejta për përfitime në lidhje me aksidentet në punë ose sëmundjet profesionale përcaktohet në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese të cilit i është nënshtruar personi i siguruar në çastin kur ka ndodhur aksidenti në punë ose gjatë kryerjes së punës si rezultat i së cilës shkaktohet sëmundja e tij profesionale.

2. Nëse puna që shkakton një sëmundje profesionale është kryer në të dyja Palët Kontraktuese, përfitimet në lidhje me këtë sëmundje jepen vetëm në përputhje me legjislacionin e asaj Pale Kontraktuese ku puna është kryer së fundmi. Nëse në bazë të këtij legjislacioni, nuk lind e drejta për përfitime, kjo e drejtë përcaktohet në përputhje me legjislacionin e Palës tjetër Kontraktuese.

3. Kur dhënia e përfitimeve në lidhje me sëmundjen profesionale sipas legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese i nënshtrohet kushtit që sëmundja profesionale të jetë diagnostikuar për herë të parë në territorin e asaj Pale Kontraktuese, ky kusht konsiderohet i realizuar nëse sëmundja është diagnostikuar për herë të parë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

4. Kur dhënia e përfitimeve në lidhje me sëmundjen profesionale sipas legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese kushtëzohet me një periudhë të caktuar të kryerjes së punës që shkaktoi sëmundjen profesionale, institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese merr gjithashtu parasysh periudhën e kryerjes së të njëjtit lloj pune sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese.

5. Neni 10 dhe 11 i kësaj Marrëveshjeje zbatohen duke marrë parasysh ndryshimet e nevojshme edhe për përfitimet në rast të paaftësisë së përkohshme në punë për shkak të një aksidenti në punë ose sëmundjes profesionale.

Neni 18
Përkeqësimi i një sëmundjeje profesionale

1. Kur e drejta për përfitime në lidhje me sëmundjen profesionale ka lindur sipas legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese, institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese është përgjegjës për pagesën e përfitimit në lidhje me përkeqësimin e sëmundjes profesionale, edhe nëse përkeqësimi ka ndodhur në momentin kur personi i siguruar i është nënshtruar legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, nëse nuk ka kryer atje punë që do ta ekspozonte ndaj një sëmundjeje profesionale.

2. Në rast të përkeqësimit të një sëmundjeje profesionale tek një person i cili merr përfitime në lidhje me sëmundjen profesionale sipas legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese, ndërsa kryen një punë që mund të shkaktojë një sëmundje profesionale në territorin e Palës tjetër Kontraktuese:

1) institucioni kompetent i Palës së parë Kontraktuese do të vazhdojë të paguajë përfitimin e dhënë, duke mos marrë parasysh përkeqësimin e sëmundjes profesionale;
2) institucioni kompetent i Palës së dytë Kontraktuese, legjislacionit të së cilës i është nënshtruar personi i siguruar gjatë kryerjes së një pune që mund të shkaktojë përkeqësimin e sëmundjes profesionale, jep një përfitim në shumën e barabartë me diferencën midis shumës së përfitimit që personi i siguruar ka të drejtë pas përkeqësimit të sëmundjes profesionale dhe shumës së përfitimit që do t'i takonte para përkeqësimit të sëmundjes profesionale, sipas legjislacionit të zbatueshëm nga institucioni kompetent i kësaj Pale Kontraktuese.

KAPITULLI 5
Grantet e vdekjes

Neni 19
Përcaktimi i së drejtës

1. E drejta për grantin e vdekjes përcaktohet nga institucioni kompetent i Palës Kontraktuese, legjislacioni i së cilës zbatohet për punonjësin, personin e vetëpunësuar ose pensionistin në çastin e vdekjes së tij/saj.
2. Kur si pasojë e vdekjes së një pensionisti që merr përfitime sipas legjislacionit të secilës prej Palëve Kontraktuese, e drejta për grantin e vdekjes i takon nga legjislacioni i secilës Palë Kontraktuese, granti i vdekjes do të jepet nga institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese në territorin e të cilës banonte pensionisti në çastin e vdekjes së tij/saj.

3. Kur pensionisti i përmendur në paragrafin 2 nuk e ka patur vendbanimin në territorin e asnjërës prej Palëve Kontraktuese në çastin e vdekjes së tij/saj, e drejta për pagesën e vdekjes përcaktohet nga institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese në territorin e së cilës janë realizuar periudhat e fundit të sigurimit.

4. Dispozitat e paragrafeve 1-3 zbatohen përkatësisht për personat e specifikuar në paragrafin 2 të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

PJESA IV
DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 20
Kompetencat e organeve kompetente

Për qëllim të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente:
1) lidhin marrëveshje administrative e cila përcakton procedurat e nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;
2) caktojnë organet ndërlidhëse dhe institucionet kompetente për të lehtësuar dhe përshpejtuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;
3) shkëmbejnë informacione mbi ndryshimet legjislative të cilat mund të kenë ndikim në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21
Ndihma administrative dhe juridike

1. Autoritetet kompetente, organet ndërlidhëse dhe institucionet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese i ofrojnë ndihmë reciproke njëra-tjetrës për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje. Ndihma është pa pagesë, përveç rasteve kur autoritetet kompetente vendosin që disa shpenzime të ndihmës do të rimbursohen.

2. Çertifikatat ose dokumentet e lëshuara nga autoritetet kompetente, organet ndërlidhëse dhe institucionet kompetente të njërës prej Palëve Kontraktuese pranohen nga autoritetet kompetente, organet ndërlidhëse dhe institucionet kompetente të Palës tjetër Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente, organet ndërlidhëse dhe institucionet kompetente të Palëve Kontraktuese mund të kontaktojnë drejtpërdrejt me njëra-tjetrën, si dhe çdo person të interesuar ose përfaqësuesin e tij ligjor.

Neni 22
Mbrojtja e të dhënave personale

1. Çdo informacion që mundëson identifikimin e një personi fizik përbën të dhëna personale. Të dhënat personale i nënshtrohen mbrojtjes nga dispozitat ligjore të secilës Palë Kontraktuese.

2. Autoritetet kompetente, organet ndërlidhëse dhe institucionet kompetente të secilës Palë Kontraktuese mund të shkëmbejnë të dhënat personale të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

3. Të dhënat personale të transferuara tek autoriteti kompetent, organi ndërlidhës dhe institucioni kompetent i njërës Palë Kontraktuese përdoren ekskluzivisht për qëllimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

4. Pala Kontraktuese mund të përdorë të dhënat personale për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara në paragrafin 3, me pëlqimin e personit të interesuar ose pa pëlqimin e tij, në rastin kur përdorimi i të dhënave është në interes të dukshëm të personit të interesuar.

5. Të dhënat personale të dërguara në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje tek një autoritet kompetent, organ ndërlidhës dhe institucion kompetent i njërës Palë Kontraktuese mund t'i kalojnë një institucioni tjetër të asaj Pale Kontraktuese vetëm me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

6. Transferimi i të dhënave personale sipas paragrafit 5 mund të ndodhë me pëlqimin e personit të interesuar ose pa pëlqimin e tij, vetëm në rastin e përdorimit të të dhënave në interes të dukshëm të personit të interesuar.

7. Autoritetet kompetente, organet ndërlidhëse, institucionet kompetente dhe institucionet e tjera të secilës Palë Kontraktuese garantojnë gjatë transferimit të të dhënave personale të specifikuara në paragrafin 2 dhe gjatë përpunimit të tyre,

zbatimin e masave për të siguruar mbrojtjen e këtyre të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara, ndryshimet dhe transferimi i tyre.

8. Për zbatimin e paragrafit 7, Palët Kontraktuese bien dakord që autoritetet kompetente, organet ndërlidhëse, institucionet kompetente dhe institucionet e tjera të secilës Palë Kontraktuese, të cilat kanë marrë të dhëna personale, janë të detyruara:
   1) të zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm për rrezikun e shkeljes së të drejtave dhe lirive të personave me probabilitet dhe rrezikshmëri të ndryshme, veçanërisht si rezultat i një dëmi të veçantë ose të paligjshëm, humbjeje, modifikimi, zbulimi të paautorizuar ose ndërhyrjeje të paautorizuar për të dhënat e transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara ndryshe;
   2) të sigurojnë që të gjithë personat që veprojnë me autorizimin e autoritetit kompetent, organit ndërlidhës, institucionit kompetent dhe institucioneve të tjera të secilës Palë Kontraktuese që kanë akses në të dhënat personale, t'i përpunojnë të dhënat vetëm në bazë të urdhrit të autoritetit kompetent, organit ndërlidhës, institucionit kompetent apo një institucioni tjetër.

9. Autoriteti kompetent, organi ndërlidhës, institucioni kompetent dhe një institucion tjetër i një Pale Kontraktuese është i detyruar të informojë personin, të dhënat personale të të cilit përpunohen sipas kësaj Marrëveshjeje për:
   1) institucionin kompetent që zbaton dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;
   2) qëllimet e përpunimit të të dhënave personale dhe bazën ligjore të përpunimit të të dhënave personale;
   3) kategoritë e të dhënave personale të përpunuara;
   4) institucionet tek të cilat do të transferohen të dhënat personale me qëllim zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje;
   5) periudhën gjatë së cilës do të ruhen të dhënat personale;
   6) të drejtën për të kërkuar qasje në të dhënat personale, korrigjimin, fshirjen ose kufizimin e përpunimit të të dhënave;
   7) të drejtën për të tërhequr pëlqimin për përpunimin e të dhënave;
   8) të drejtën për t'u ankuar në një autoritet të pavarur administrativ kompetent ose gjykatën e Palës Kontraktuese në rast të shkeljes së të drejtave në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

10. Autoriteti kompetent, organi ndërlidhës, institucioni kompetent dhe një institucion tjetër i një Pale Kontraktuese të dhënat personale të specifikuara në paragrafin 3 të të cilit janë transferuar, do të ndërmarrë masat e nevojshme për t'i mbajtur të dhënat të përditësuara, të plota dhe të sakta për qëllimet për të cilat janë mbledhur. Kur është e nevojshme, të dhënat korrigjohen kurse të dhënat e mbledhura ose të ruajtura në mënyrë që bien ndesh me dispozitat ligjore në fuqi, asgjësohen. Me kërkesë të Palës Kontraktuese që ka transferuar të dhënat personale, asgjësohen gjithashtu të dhënat, transferimi i të cilave është i ndaluar nga dispozitat ligjore të kësaj Pale Kontraktuese.

11. Të dhënat personale të marra nga Pala Kontraktuese lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të shkatërrohen me arritjen e qëllimeve për të cilat ato janë mbledhur ose përdorur. Autoritetet kompetente, organet ndërlidhëse, institucionet kompetente dhe institucionet e tjera të secilës Palë Kontraktuese

zbatojnë masa të sigurta që mundësojnë shkatërrimin e plotë të të dhënave dhe garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale që synohen të shkatërrohen.

12. Me kërkesën e dorëzuar pranë një autoriteti kompetent, organit ndërlidhës dhe institucionit kompetent të Palës Kontraktuese, personi i interesuar ka të drejtën të informohet për transferimin e të dhënave personale të specifikuara në paragrafin 3 dhe përdorimin e tyre për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Personit në fjalë gjithashtu mund t'i jepet akses në të dhënat e tij personale dhe të kërkojë korrigjimin, fshirjen, kufizimin e përpunimit ose të paraqesë kundërshtimin ndaj përpunimit të të dhënave personale.

13. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese ose institucionet e autorizuara prej tyre informojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim në dispozitat ligjore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, nëse këto ndryshime ndikojnë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

14. Palët Kontraktuese janë të detyruara të informojnë njëra-tjetrën për shkeljen e mbrojtjes së të dhënave personale të transferuara sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse kjo mund të shkaktojë një rrezik të lartë të shkeljes së të drejtave dhe lirive të personave, të dhënat e të cilëve janë përpunuar.

15. Palët Kontraktuese janë të detyruara të marrin çdo masë të mundshme me qëllim parandalimin e pasojave të shkeljes së specifikuar në paragrafin 14 si dhe sigurimin e ushtrimit të të drejtave të personave, të dhënat personale të të cilëve janë transferuar.

16. Personat, të dhënat personale të të cilëve përpunohen sipas kësaj Marrëveshjeje, kanë të drejtë të ankohen pranë autoritetit të pavarur administrativ ose në gjykatën e një Pale Kontraktuese nëse konsiderojnë se të dhënat e tyre personale të transferuara sipas kësaj Marrëveshjeje po përpunohen ose janë përpunuar jo saktësisht ose të drejtat e tyre që lidhen me përpunimin e të dhënave personale janë shkelur.

17. Dispozitat e paragrafit 3 dhe paragrafëve në vijim zbatohen në masën e nevojshme për të dhëna të tjera të mbrojtura të siguruara gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje ose në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 23
Përjashtim nga tarifat dhe vërtetimi i dokumenteve

1. Kur legjislacioni i një Pale Kontraktuese parashikon që një kërkesë, certifikatë ose dokument nuk i nënshtrohet ose përjashtohet tërësisht ose pjesërisht nga tarifat, ky përjashtim do të zbatohet në të njëjtën masë për çdo kërkesë, certifikatë ose dokument të paraqitur në përputhje me legjislacionin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Dokumentet, vërtetimet dhe kërkesat e çfarëdolloj të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë të përjashtuara nga verifikimi i autoriteteve diplomatike dhe konsullore.

3. Kopjet e dokumenteve, vërtetimeve dhe kërkesave të njehsuara me origjinalin nga autoriteti kompetent, organi ndërlidhës dhe institucioni kompetent i njërës Palë Kontraktuese, pranohen dhe konsiderohen si origjinale nga autoriteti kompetent, organi ndërlidhës dhe institucioni kompetent i Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 24
Dorëzimi i dokumenteve

1. Kërkesat, ankimimet kundër vendimeve dhe deklaratat e dorëzuara pranë autoritetit kompetent, organit ndërlidhës ose institucionit kompetent të njërës Palë Kontraktuese konsiderohen si të dorëzuara në të njëjtën datë tek autoriteti kompetent, organi ndërlidhës ose institucioni kompetent i Palës tjetër Kontraktuese.

2. Kërkesa për përfitime sipas legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese konsiderohet si kërkesë për përfitime përkatëse sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, përveç rasteve kur kërkuesi kërkon dhënien e së drejtës të përfitimit në përputhje me legjislacionin e vetëm njërës Palë Kontraktuese.

Neni 25
Transmetimi elektronik

1. Informacionet dhe dokumentet mund të transmetohen ndërmjet institucioneve kompetente ose organeve ndërlidhëse me mjete elektronike. Në një rast të tillë, ato konsiderohen të barasvlershme me informacionet dhe dokumentet shkresore.

2. Informacioni dhe dokumentet e transmetuara në rrugë elektronike përbëjnë prova në procedurat e sigurimeve shoqërore të kryera sipas fushëveprimit material të kësaj Marrëveshjeje.

3. Shkëmbimi elektronik i informacionit ka të bëjë me shkëmbimin në raste individuale, si dhe shkëmbimin masiv të informacionit që lidhet me më shumë se një person të përfshirë në objektin e Marrëveshjes. Në raste të tilla, shkëmbimi elektronik i informacionit rregullohet nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë teknike midis institucioneve kompetente ose organeve ndërlidhëse të Palëve Kontraktuese.

Neni 26
Përcaktimi i paaftësisë për punë

1. Institucioni kompetent i secilës Palë Kontraktuese vlerëson paaftësinë për punë në përputhje me legjislacionin që ai zbaton.

2. Institucioni kompetent i njërës Palë Kontraktuese i vë në dispozicion pa pagesë institucionit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese, çdo informacion dhe dokumentacion mjekësor që disponon në lidhje me paaftësinë për punë të kërkuesit apo përfituesit të invaliditetit.

3. Ekzaminimet mjekësore shtesë me qëllim zbatimin e legjislacionit vetëm të njërës Palë Kontraktuese që kanë të bëjnë me personat me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, kryhen nga institucioni kompetent i vendbanimit ose vendqëndrimit me kërkesë dhe me shpenzimet e institucionit kompetent të Palës Kontraktuese që i kërkon këto ekzaminime.

Neni 27
Gjuha e komunikimit

1. Për qëllimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente, organet ndërlidhëse dhe institucionet kompetente të Palëve Kontraktuese përdorin gjuhën zyrtare të secilës Palë Kontraktuese ose gjuhën angleze.

2. Autoritetet kompetente, organet ndërlidhëse dhe institucionet kompetente të njërës Palë Kontraktuese nuk mund të refuzojnë kërkesat, ankimimet ndaj vendimeve ose dokumentet e tjera që u janë dërguara atyre me arsyetimin se dokumentet janë hartuar në gjuhën zyrtare të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 28
Pagesa e përfitimeve

Institucionet kompetente të secilës Palë Kontraktuese ua paguajnë përfitimet në para sipas kësaj Marrëveshjeje drejtpërdrejt personave përfitues të cilët e kanë vendbanimin në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, në monedhën zyrtare të shtetit të tij ose në një monedhë tjetër lirisht të konvertueshme.

Neni 29
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet Palëve Kontraktuese në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet bashkarisht nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese nëpërmjet konsultimit dhe negocimit.

PJESA V
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 30
Dispozitat kalimtare

1. Kjo Marrëveshje nuk përcakton asnjë të drejtë për pagesën e përfitimeve për periudhën përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Periudhat e sigurimit të realizuara në përputhje me legjislacionin e Palëve Kontraktuese përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje merren parasysh gjatë përcaktimit të së drejtës për përfitime sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Në varësi të paragrafit 1, kjo Marrëveshje zbatohet gjithashtu për ngjarjet e sigurimit që kanë ndodhur para datës së hyrjes së saj në fuqi, përveç rasteve kur detyrimet që rrjedhin nga këto ngjarje janë zgjidhur më parë.

4. Kur paragrafët 1 dhe 2 të nenit 7 të kësaj Marrëveshjeje zbatohen për personat të cilët e kryejnë aktivitetin e tyre si të punësuar ose të vetëpunësuar në territorin e Palës Kontraktuese përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, konsiderohet se periudhat e punësimit si të punësuar apo të vetëpunësuar të përmendura në atë nen, fillojnë në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 31
Detyrimi dhe zgjidhja e marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pakufizuar. Secila nga Palët Kontraktuese mund ta zgjidhin këtë Marrëveshje me anë të një njoftimi me shkrim, jo më vonë se gjashtë muaj përpara përfundimit të një viti kalendarik. Në një rast të tillë, kjo Marrëveshje pushon së qeni detyruese në fund të vitit.

2. Në rast të zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje, të gjitha të drejtat e fituara sipas dispozitave të saj ruhen.

3. Kërkesat e paraqitura përpara datës në të cilën kjo Marrëveshje pushon së qeni detyruese shqyrtohen në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 32
Hyrja në fuqi e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të gjashtë që pason datën e marrjes së njoftimit të fundit me të cilat Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme që kërkohen për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të poshtënënshkruarit, të autorizuar në mënyrë të rregullt, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

NËNSHKRUAR në ....Vorshavë..... më 23 Shkurt... viti 2026....., në dy kopje identike, secili në gjuhët Shqipe, Polake dhe Angleze, ku të gjitha tekstet janë autentike. Në rast të ndonjë divergjence në interpretim, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	**PËR REPUBLIKËN E POLONISË**

UMOWA

MIĘDZY

REPUBLIKĄ ALBANII

A

RZECZĄPOSPOLITĄ POLSKĄ

O ZABEZPIECZENIU SPOŁECZNYM

Republika Albanii
i
Rzeczpospolita Polska,

zwane dalej „Umawiającymi się Stronami",
pragnąc uregulować wzajemne stosunki między obu Państwami w zakresie zabezpieczenia społecznego uzgodniły, co następuje:

CZĘŚĆ I
POSTANOWIENIA OGÓLNE

Artykuł 1
Definicje

1. W niniejszej Umowie poniższe pojęcia oznaczają:
   1) „ustawodawstwo" – ustawy i inne akty prawne każdej z Umawiających się Stron dotyczące zakresu przedmiotowego niniejszej Umowy, o którym mowa w artykule 2 niniejszej Umowy;
   2) „władza właściwa" – ministra lub ministrów właściwych do spraw zabezpieczenia społecznego;
   3) „instytucja właściwa" – instytucję odpowiedzialną za stosowanie ustawodawstwa;
   4) „instytucja łącznikowa" – instytucję zapewniającą koordynację i wymianę informacji między instytucjami Umawiających się Stron w celu stosowania niniejszej Umowy;
   5) „miejsce zamieszkania" – miejsce stałego zamieszkania określone zgodnie z przepisami prawa Umawiającej się Strony;
   6) „miejsce pobytu" – miejsce czasowego pobytu określone zgodnie z przepisami prawa Umawiającej się Strony;
   7) „okres ubezpieczenia" – okresy składkowe, okresy zatrudnienia lub okresy pracy
      na własny rachunek, określone lub uznane za takie przez ustawodawstwo, zgodnie
      z którym zostały one przebyte, oraz okresy z nimi zrównane, zgodnie z ustawodawstwem Umawiającej się Strony;
   8) „ubezpieczony" – osobę, która jest lub była ubezpieczona zgodnie z ustawodawstwem Umawiającej się Strony;
   9) „świadczenia" – świadczenia pieniężne, o których mowa w artykule 2 ustęp 1 niniejszej Umowy, przewidziane przez ustawodawstwo każdej z Umawiających się Stron, w tym podwyżki, dodatki i dopłaty;
   10) „przekazywanie drogą elektroniczną" – oznacza przekazywanie danych z wykorzystaniem każdego środka transmisji elektronicznej.

2. Inne pojęcia użyte w niniejszej Umowie mają znaczenie nadane im przez ustawodawstwo każdej z Umawiających się Stron.

Artykuł 2
Zakres przedmiotowy

1. Umowę niniejszą stosuje się do ustawodawstwa dotyczącego:
   1) w Republice Albanii: następujących świadczeń z systemu ubezpieczeń społecznych:
      (1) emerytur, rent z tytułu niezdolności do pracy oraz rent rodzinnych,
      (2) świadczeń w razie choroby,
      (3) świadczeń z tytułu macierzyństwa,
      (4) świadczeń z tytułu wypadków w pracy i chorób zawodowych,
      (5) zasiłków dla bezrobotnych;

2) w Rzeczypospolitej Polskiej: obowiązkowego ubezpieczenia społecznego i następujących świadczeń z zabezpieczenia społecznego:
   (1) zasiłków dla bezrobotnych
   oraz z powszechnego ubezpieczenia społecznego i ubezpieczenia społecznego rolników:
   (2) świadczeń w razie choroby i macierzyństwa,
   (3) emerytur, rent z tytułu niezdolności do pracy oraz rent rodzinnych,
   (4) jednorazowych odszkodowań, zasiłków i rent z tytułu wypadków przy pracy i chorób zawodowych,
   (5) zasiłków pogrzebowych.

2. Umowę niniejszą stosuje się również do wszystkich ustaw i innych przepisów prawnych, zmieniających lub uzupełniających ustawodawstwo.

3. Umowy niniejszej nie stosuje się do ustaw ani innych przepisów prawnych, które rozszerzają istniejące ustawodawstwo jednej Umawiającej się Strony na nowe kategorie świadczeniobiorców, jeżeli władze właściwe tej Umawiającej się Strony zawiadomią władze właściwe drugiej Umawiającej się Strony, w ciągu sześciu miesięcy od daty ogłoszenia takich nowych ustaw lub innych przepisów prawnych, o tym, że nie przewiduje się takiego rozszerzenia niniejszej Umowy.

Artykuł 3
Zakres podmiotowy

Umowę niniejszą stosuje się do:
1) osób, które podlegały lub podlegają ustawodawstwu jednej lub obu Umawiających się Stron;
2) innych osób, jeżeli wywodzą swoje prawa od osób wymienionych w punkcie 1.

Artykuł 4
Równe traktowanie

Jeżeli niniejsza Umowa nie stanowi inaczej, osoby, do których stosują się postanowienia niniejszej Umowy, podlegają obowiązkom i korzystają z uprawnień wynikających z ustawodawstwa drugiej Umawiającej się Strony na tych samych warunkach, co obywatele tej Umawiającej się Strony.

Artykuł 5
Transfer świadczeń

1. Jeżeli niniejsza Umowa nie stanowi inaczej, świadczenia przysługujące na podstawie ustawodawstwa jednej Umawiającej się Strony nie mogą ulec zmniejszeniu, zawieszeniu, uchyleniu lub wstrzymaniu z tego powodu, że uprawniony ma miejsce zamieszkania na terytorium drugiej Umawiającej się Strony.

2. Postanowień ustępu 1 nie stosuje się:
   1) w Republice Albanii do: świadczeń, rekompensat lub dodatków o charakterze nieskładkowym;
   2) w Rzeczypospolitej Polskiej do: zasiłków dla bezrobotnych i świadczeń przyznawanych w szczególnym trybie oraz w drodze wyjątku.

CZĘŚĆ II
USTAWODAWSTWO WŁAŚCIWE

Artykuł 6
Postanowienia ogólne

Jeżeli artykuły 7 i 8 niniejszej Umowy nie stanowią inaczej:
1) osoba zatrudniona na terytorium Umawiającej się Strony podlega, w odniesieniu do tego zatrudnienia, wyłącznie ustawodawstwu tej Umawiającej się Strony;
2) osoba prowadząca działalność na własny rachunek na terytorium Umawiającej się Strony podlega, w odniesieniu do tej działalności, wyłącznie ustawodawstwu tej Umawiającej się Strony.

Artykuł 7
Postanowienia szczególne

1. Jeżeli osoba zatrudniona przez pracodawcę mającego siedzibę na terytorium jednej Umawiającej się Strony zostanie wysłana na terytorium drugiej Umawiającej się Strony, w celu wykonywania pracy na rachunek tego pracodawcy, podlega ona ustawodawstwu pierwszej Umawiającej się Strony, pod warunkiem że przewidywany okres wykonywania pracy nie przekracza 24 miesięcy i osoba ta nie jest wysłana, aby zastąpić osobę, której okres wysłania upłynął.

2. Osoba prowadząca działalność na własny rachunek, wykonująca swą działalność na terytorium jednej Umawiającej się Strony, która czasowo wykonuje tę działalność na terytorium drugiej Umawiającej się Strony, podlega ustawodawstwu pierwszej Umawiającej się Strony przez okres wykonywania tej działalności, nie dłużej jednak niż przez 24 miesiące.

3. Jeżeli okres wykonywania pracy, o którym mowa w ustępie 1, lub okres wykonywania działalności, o którym mowa w ustępie 2, przedłuży się ponad 24 miesiące, ustawodawstwo pierwszej Umawiającej się Strony jest nadal stosowane przez kolejny okres nieprzekraczający 24 miesięcy, pod warunkiem że władza właściwa drugiej Umawiającej się Strony lub instytucja upoważniona przez tę władzę udzieli na to zgody.

4. Personel przedsiębiorstwa transportowego wykonujący międzynarodowe przewozy osób i towarów koleją, drogą lądową, powietrzną lub przez wody śródlądowe na terytoriach obu Umawiających się Stron podlega

ustawodawstwu tej Umawiającej się Strony, na której terytorium przedsiębiorstwo ma siedzibę.

5. Osoba zatrudniona na statku pływającym pod banderą jednej z Umawiających się Stron podlega ustawodawstwu tej Umawiającej się Strony.

6. Urzędnicy i osoby z nimi zrównane podlegają ustawodawstwu tej Umawiającej się Strony, której administracja ich zatrudnia.

7. Członkowie misji dyplomatycznych oraz urzędów konsularnych podlegają postanowieniom Konwencji Wiedeńskiej o stosunkach dyplomatycznych, sporządzonej w Wiedniu dnia 18 kwietnia 1961 roku oraz Konwencji Wiedeńskiej o stosunkach konsularnych, sporządzonej w Wiedniu dnia 24 kwietnia 1963 roku.

Artykuł 8
Wyjątki

Władze właściwe obu Umawiających się Stron lub upoważnione przez nie instytucje mogą, za obopólną zgodą, ustalić wyjątki od postanowień artykułu 6 i artykułu 7 ustępy 1 do 6 niniejszej Umowy, w odniesieniu do jakiejkolwiek osoby lub grupy osób i w ich interesie.

CZĘŚĆ III
POSTANOWIENIA DOTYCZĄCE ŚWIADCZEŃ

ROZDZIAŁ 1
Zasiłki dla bezrobotnych

Artykuł 9
Ustalanie prawa

1. Okresy ubezpieczenia przebyte zgodnie z ustawodawstwem jednej z Umawiających się Stron są uwzględniane, jeżeli jest to niezbędne i jeżeli się one nie pokrywają, przy ustalaniu prawa do zasiłku dla bezrobotnych zgodnie z ustawodawstwem drugiej Umawiającej się Strony, jeżeli bezrobotny posiada okresy ubezpieczenia przebyte bezpośrednio przed utratą pracy zgodnie z ustawodawstwem tej drugiej Umawiającej się Strony.

2. Okres wypłacania zasiłku dla bezrobotnych podlega skróceniu o okres, w którym bezrobotny otrzymywał taki zasiłek na terytorium drugiej Umawiającej się Strony w okresie ostatnich 12 miesięcy przed dniem rejestracji jako osoba bezrobotna.

ROZDZIAŁ 2
Choroba i macierzyństwo

Artykuł 10
Uwzględnianie okresów ubezpieczenia

Okresy ubezpieczenia przebyte zgodnie z ustawodawstwem każdej z Umawiających się Stron są uwzględniane, w niezbędnym zakresie, przy ustalaniu prawa do świadczeń, ich wysokości i okresu ich przysługiwania, pod warunkiem że się nie pokrywają.

Artykuł 11
Świadczenia

1. Świadczenia w razie choroby i macierzyństwa są przyznawane i wypłacane przez instytucję właściwą tej Umawiającej się Strony, której ustawodawstwu podlegał ubezpieczony w chwili nabycia prawa do tych świadczeń, nawet jeżeli ubezpieczony ma miejsce pobytu na terytorium drugiej Umawiającej się Strony.

2. Świadczenia w razie choroby i macierzyństwa są wypłacane bezpośrednio osobie uprawnionej przez instytucję właściwą zgodnie z artykułem 28 niniejszej Umowy.

ROZDZIAŁ 3
Emerytury, renty z tytułu niezdolności do pracy i renty rodzinne

Artykuł 12
Sumowanie okresów ubezpieczenia

1. Jeżeli ustawodawstwo jednej Umawiającej się Strony uzależnia nabycie, zachowanie lub przywrócenie prawa do emerytury lub renty od przebycia określonego okresu ubezpieczenia, to instytucja właściwa tej Umawiającej się Strony uwzględnia, jeśli to konieczne, okresy ubezpieczenia przebyte zgodnie z ustawodawstwem drugiej Umawiającej się Strony, tak jakby były okresami ubezpieczenia przebytymi zgodnie ze stosowanym przez nią ustawodawstwem, pod warunkiem że okresy te się nie pokrywają.

2. Jeżeli ustawodawstwo jednej Umawiającej się Strony uzależnia nabycie prawa do emerytury lub renty od przebycia okresów ubezpieczenia w zawodzie objętym ubezpieczeniem w systemie specjalnym lub od wykonywania określonego zatrudnienia, to okresy ubezpieczenia przebyte w tym zawodzie lub w tym zatrudnieniu zgodnie z ustawodawstwem drugiej Umawiającej się Strony są sumowane przy przyznawaniu emerytury lub renty.

3. Jeżeli po zsumowaniu, zgodnie z ustępem 1, ubezpieczony nie nabywa prawa do emerytury lub renty, instytucja właściwa Umawiającej się Strony uwzględnia okres ubezpieczenia przebyty w państwie trzecim, z którym obie

Umawiające się Strony są związane międzynarodową umową przewidującą sumowanie okresów ubezpieczenia.

Artykuł 13
Okresy ubezpieczenia krótsze niż 12 miesięcy

1. Jeżeli okresy ubezpieczenia przebyte zgodnie z ustawodawstwem jednej Umawiającej się Strony są krótsze niż 12 miesięcy i zgodnie z ustawodawstwem tej Umawiającej się Strony zainteresowany nie nabywa prawa do emerytury lub renty, to instytucja właściwa tej Umawiającej się Strony nie przyznaje emerytury lub renty.

2. Nie naruszając postanowień ustępu 1, okresy ubezpieczenia krótsze niż 12 miesięcy, przebyte zgodnie z ustawodawstwem każdej z Umawiających się Stron, są uwzględniane przez instytucję właściwą tej Umawiającej się Strony, w której po zsumowaniu tych okresów powstanie prawo do emerytury lub renty.

Artykuł 14
Zrównanie faktów i zdarzeń

Fakty i zdarzenia, które mają wpływ na nabycie prawa, zawieszenie lub wysokość emerytury lub renty, które zaistniały na terytorium jednej Umawiającej się Strony, są uwzględniane, tak jakby zaistniały na terytorium drugiej Umawiającej się Strony.

Artykuł 15
Emerytury i renty bez sumowania okresów ubezpieczenia

Jeżeli osoba spełnia warunki niezbędne do nabycia prawa do emerytury lub renty zgodnie z ustawodawstwem jednej z Umawiających się Stron, bez uwzględnienia okresów ubezpieczenia przebytych zgodnie z ustawodawstwem drugiej Umawiającej się Strony, to instytucja właściwa pierwszej Umawiającej się Strony ustala prawo i oblicza wysokość emerytury lub renty wyłącznie na podstawie okresów ubezpieczenia przebytych zgodnie ze stosowanym przez nią ustawodawstwem.

Artykuł 16
Emerytury i renty z sumowaniem okresów ubezpieczenia

1. Jeżeli zgodnie z ustawodawstwem jednej z Umawiających się Stron prawo do emerytury lub renty przysługuje dopiero po zastosowaniu postanowień artykułu 12 niniejszej Umowy, instytucja właściwa tej Umawiającej się Strony ustala emeryturę lub rentę w następujący sposób:
   1) oblicza teoretyczną wysokość emerytury lub renty, należną w przypadku, gdyby wszystkie okresy ubezpieczenia zostały przebyte zgodnie z

obowiązującym
ją ustawodawstwem;

2) na podstawie teoretycznej wysokości, o której mowa w punkcie 1, określa rzeczywistą wysokość emerytury lub renty w oparciu o proporcję okresów ubezpieczenia przebytych zgodnie z ustawodawstwem, które stosuje, do sumy wszystkich przebytych okresów ubezpieczenia;
3) jeżeli łączne okresy ubezpieczenia zsumowane zgodnie z artykułem 12 niniejszej Umowy przekraczają maksymalny okres ubezpieczenia przewidziany ustawodawstwem, które stosuje, instytucja ta ustala wysokość świadczenia jako proporcję okresów ubezpieczenia przebytych według tego ustawodawstwa, w stosunku do maksymalnego okresu ubezpieczenia branego pod uwagę do obliczenia pełnej wysokości świadczenia na podstawie ustawodawstwa tej Umawiającej się Strony.

2. Przy ustalaniu podstawy wymiaru emerytury lub renty instytucja właściwa każdej z Umawiających się Stron uwzględnia wyłącznie wynagrodzenie uzyskane zgodnie z ustawodawstwem stosowanym przez tę instytucję oraz składki odprowadzone zgodnie z tym ustawodawstwem.

ROZDZIAŁ 4
Wypadki przy pracy i choroby zawodowe

Artykuł 17
Prawo do świadczeń

1. For the purpose of implementing this Agreement, the competent authorities, liaison bodies and competent institutions of the Contracting Parties shall use the official language of each Contracting Party or the English language.

2. The competent authorities, liaison bodies and competent institutions of one Contracting Party shall not refuse claims, appeals against decisions or other documents sent to them on the grounds that the documents are drawn up in the official language of the other Contracting Party.

Article 28
Payment of benefits

The competent institutions of each Contracting Party shall pay cash benefits under this Agreement directly to the entitled person who has the place of residence in the territory of the other Contracting Party, in the official currency of its State or in another freely convertible currency.

Article 29
Settlement of Disputes

Any dispute arising between the Contracting Parties concerning the implementation and interpretation of this Agreement shall be settled jointly by the competent authorities of the Contracting Parties through consultation and negotiation.

PART V
TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS

Article 30
Transitional provisions

1. This Agreement shall not establish any right to the payment of benefits for the period prior to the date of its entry into force.

2. Periods of insurance completed in accordance with the legislation of the Contracting Parties prior to the date of entry into force of this Agreement shall be taken into account when determining the right to benefits under this Agreement.

3. Subject to paragraph 1, this Agreement shall also apply to insurance events which occurred prior to the date of its entry into force, unless the obligations arising from these events have been settled earlier.

4. In cases when Article 7 paragraphs 1 and 2 of this Agreement apply to persons who pursue their employment or self-employment in the territory of a Contracting Party before the date of entry into force of this Agreement, the periods of employment or self-employment referred to in that Article, shall be deemed to have commenced on the date of entry into force of this Agreement.

Article 31
Duration and termination

1. This Agreement is concluded for an unlimited period of time. Either Contracting Party may terminate this Agreement by giving written notice not later than six months before the end of a calendar year. In such a case, this Agreement shall cease to be binding at the end of the year.

2. In the event of termination of this Agreement all rights acquired under its provisions shall be maintained.

3. Claims submitted before the date on which this Agreement ceases to be binding shall be considered in accordance with the provisions of this Agreement.

Article 32
Entry into force of the Agreement

This Agreement shall enter into force on the first day of the sixth month following the date of receipt of the later notification by which the Contracting Parties notify each other of the completion of their internal procedures required for the entry into force of this Agreement.

IN WITNESS WHEREOF, the undersigned, being duly authorized thereto, have signed this Agreement.

SIGNED at ..... on ..... in the year ....., in duplicate, each in the Albanian, Polish and English languages, all texts being equally authentic. In the event of any divergence of interpretation, the English text shall prevail.

FOR THE REPUBLIC OF ALBANIA

FOR THE REPUBLIC OF POLAND

DEKRET
Nr. 358, datë 23.6.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 55/2026, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Polonisë për sigurimet shoqërore".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

URDHËR
Nr. 653, datë 18.6.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E KROACISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	**Ndarja administrative e nivelit 2**	**Ndarja administrative e nivelit 3**
Osjecko-Baranjska	Đurđenovac*	
Osjecko-Baranjska	Erdut*	
Osjecko-Baranjska	Kneževi Vinogradi*	
Osjecko-Baranjska	Magadenovac*	
Osjecko-Baranjska	Osijek*	
Osjecko-Baranjska	Viljevo*	
Virovitičko-Podravska	**Crnac***	
Virovitičko-Podravska	Zdenci*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Kroacisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 646, datë 17.6.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin Kroacisë", shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 654, datë 19.6.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Hungarisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Baranya	Siklós*	
Baranya	Szigetvár*	
Borsod-Abaúj-Zemplén	Sátoraljaújhely*	
Somogy	Kadarkút*	
Somogy	Kaposvár*	
Veszprém	Tapolca*	
Zala	Keszthely*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (test PCR-je) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28

dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 1379, datë 17.12.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Hungarisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA MANJANI KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 32283/23)

VENDIM

Neni 8 • Jeta private • Refuzim joproporcional i pranimit të kërkuesit në Shkollën e Magjistraturës për formim si prokuror për shkak të një dënimi ndaj tij si i mitur për vjedhje për të cilin ai ishte rehabilituar ligjërisht • Neni 8 i zbatueshëm duke ndjekur si qasjet e bazuara në arsye ashtu edhe ato të bazuara në pasoja • Ndalimi absolut dhe i përhershëm i pranimit pati një ndikim të qartë dhe serioz në zgjedhjen personale të kërkuesit, në lidhje me mënyrën se si ai dëshironte të ndiqte jetën e tij profesionale dhe private, të formonte identitetin e tij shoqëror dhe të zhvillonte marrëdhënie me të tjerët • Mosmarrja në konsideratë e moshës së kërkuesit në kohën e veprës penale dhe vëmendje e pamjaftueshme ndaj rrethanave përkatëse • Masa e kontestuar e vendosur në një fazë të hershme të jetës së tij profesionale me një efekt të rëndësishëm në aspektin e kohëzgjatjes së saj • Moskryerja e një vlerësimi të plotë dhe mjaftueshëm të individualizuar të situatës personale të kërkuesit.

Përgatitur nga Regjistri. Nuk detyron Gjykatën.

STRASBURG
10 mars 2026

Ky vendim do të bëhet përfundimtar sipas rrethanave të parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet subjekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Manjani kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *Kryetar,*
Lətif Hüseynov,
Darian Pavli,

Úna Ní Raifeartaigh,
Mateja Đurović
Canòlic Mingorance Cairat,
Vasilka Sancin, *gjyqtarë*
dhe Milan Blaško, *regjistrar i Seksionit,*
Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 32283/23) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), më 21 gusht 2023, nga një shtetas shqiptar, z. Shiqiri Manjani (kërkuesi);

vendimin për të njoftuar qeverinë shqiptare (qeveria) për ankesën në lidhje me vendimin për të mos pranuar kërkuesin në Shkollën e Magjistraturës për shkak të një *spent juvenile conviction*, dhe për të deklaruar të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura, më 10 shkurt 2026,

Shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në të njëjtën datë:

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me refuzimin e pranimit të kërkuesit në Shkollën e Magjistraturës për formim si prokuror për shkak të një dënimi për vjedhje të kryer kur ai ishte i mitur, për të cilin më pas ishte rehabilituar ligjërisht.

FAKTET

2. Kërkuesi ka lindur në vitin 1991 dhe jeton në Pogradec. Ai u përfaqësua nga z. E. Yzeiraj, një avokat që ushtron profesionin në Tiranë.

3. Qeveria u përfaqësua nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmblidhen si më poshtë.

I. REFUZIMI PËR T'U PRANUAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

5. Në muajin shkurt të vitit 2020, kërkuesi aplikoi për t'u pranuar në programin trevjeçar të formimit fillestar për magjistratë (profili prokuror) në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2020–2021. Në aplikimin e tij, kërkuesi deklaroi se në vitin 2006, në moshën 15-vjeçare, ishte dënuar për vjedhje, se ishte zbatuar një dënim me kusht, dhe se ishte rehabilituar që nga 1 dhjetori 2014. Ai, gjithashtu, paraqiti një certifikatë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Ministria e Drejtësisë) e datës 29 maj 2017, e cila tregonte dënimin e tij të vitit 2006 dhe deklaronte se ai ishte rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal. Pas një vlerësimi paraprak, ai u përfshi në listën e kandidatëve që përmbushnin kriteret e pranimit për programin, e cila u miratua nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Ai e kaloi provimin e pranimit. Si pjesë e procesit të pranimit, KLP-ja më pas kreu një verifikim të pasurive të tij dhe kontrolle të të dhënave. Kërkuesi paraqiti përsëri informacion në lidhje me dënimin e tij në një formular vetëdeklarimi, në përputhje me Aktin e Dekriminalizimit (shih paragrafin 16 më poshtë).

6. Në një mbledhje plenare të mbajtur më 17 dhjetor 2020, KLP--j vendosi, me shumicë votash (shtatë me dy), se duke pasur parasysh dënimin e tij, kërkuesi nuk e plotësonte kriterin e pranimit sipas nenit 28(d) të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (shih paragrafin 14 më poshtë) dhe për këtë arsye nuk duhej të pranohej. KLP-ja deklaroi se dispozita e kontestuar duhej të lexohej në një mënyrë të tillë që të merrte parasysh të gjithë historinë kriminale të një individi, sepse legjislatura kishte shprehur qartë qëllimin e saj për të ndaluar personat me dënime penale të bëheshin pjesë e sistemit gjyqësor. Gjatë diskutimeve të saj, KLP-ja mori në konsideratë, ndër të tjera, projekt-ndryshimet në nenin 28(d) që qarkullonin në atë kohë me idenë e parashikimit që personat me dënim penal – pavarësisht rehabilitimit – nuk do të kualifikoheshin për formimin e magjistratëve. Dy anëtarë të KLP-së nuk ishin dakord, duke deklaruar në mendimin e tyre mospajtues se, sipas nenit 69(b) të Kodit Penal (shih paragrafin 18 më poshtë), kërkuesi konsiderohej se nuk kishte dënime. Duke miratuar dispozitën e kontestuar (që do thotë, nenin 28(d) siç ishte në fuqi në kohën e vendimit të KLP-së), legjislatura kishte hequr fjalën "asnjëherë [i dënuar]" që ishte shfaqur në projekt-propozim dhe nuk kishte përfshirë asnjë dispozitë specifike që do të përjashtonte rehabilitimin.

7. Kërkuesi apeloi kundër vendimit të KLP-së. Më 18 mars 2021, Gjykata Administrative e Apelit, me dy vota pro dhe një kundër, e rrëzoi apelin e tij. Duke iu përgjigjur argumentit të kërkuesit se sipas nenit 69(b) të Kodit Penal ai konsiderohej se nuk kishte dënime dhe se për këtë arsye nuk kishte pengesa ligjore për pranimin e tij në Shkollën e Magjistraturës, gjykata deklaroi se neni 28(d) i Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke qenë një ligj i veçantë që rregullon kushtet dhe kriteret për pranimin në atë institucion dhe duke pasur përparësi ndaj dispozitave të tjera ligjore, nuk

i referohej një supozimi juridik ose të dhënave penale, por faktit të dënimit, pavarësisht nga rehabilitimi. Në një mendim të veçantë, gjyqtari mospajtues theksoi se, në përputhje me nenin 69 të Kodit Penal mbi rehabilitimin, dënimi i kërkuesit ligjërisht nuk ekzistonte më. Për këtë arsye, fakti që ai ishte dënuar nuk binte nën kriterin përjashtues të nenit 28(d) të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas një interpretimi të drejtë të asaj dispozite, dhe për këtë arsye nuk kishte pengesa ligjore për pranimin e tij në Shkollën e Magjistraturës.

8. Kërkuesi apeloi kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Më 17 mars 2022, Gjykata e Lartë e rrëzoi unanimisht apelin e tij, duke deklaruar, ndër të tjera, se dispozita e kontestuar në nenin 28(d) të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ishte e paqartë dhe se kishte pasur probleme gjatë zbatimit të saj. Për këtë arsye, ajo ishte ndryshuar nga organi ligjvënës më 23 mars 2021 (shih paragrafin 14 më poshtë). E ndryshuar, ajo parashikonte në mënyrë të qartë se rehabilitimi nuk do të ishte vendimtar. Duke ndryshuar dispozitën në këtë mënyrë, organi ligjvënës kishte konfirmuar atë që në fakt duhej të ishte nxjerrë nga organet ligjzbatuese edhe para ndryshimit. Problemi që ndryshimi kërkonte të adresonte ishte se rehabilitimi zbatohej në parim pavarësisht se sa e rëndë ishte vepra penale, duke përfshirë edhe veprat penale shumë të rënda. Për këtë arsye, neni 28(d) i Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, edhe para ndryshimeve të vitit 2021, kishte për qëllim të ndalonte ata të dënuar me vendim të formës së prerë që të hynin në sistemin e drejtësisë, pavarësisht nga rehabilitimi apo nëse dënimi ishte shuar më pas dhe konsiderohej se nuk kishte ekzistuar. Ndalimi kishte për qëllim garantimin e integritetit të kërkuar nga një magjistrat. Vjedhja ishte një vepër e rëndë penale e kryer me dashje, e cila diskreditonte imazhin e një zyrtari publik, veçanërisht të një gjyqtari ose prokurori, për të cilin integriteti nuk ishte thjesht një virtyt, por një domosdoshmëri për të siguruar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Edhe nëse ndryshimet e vitit 2021 do të kishin qenë të zbatueshme, ato nuk do t'i kishin sjellë përfitime kërkuesit për shkak të vetë natyrës së veprës penale të kryer, pavarësisht kalimit të kohës. Këto ndryshime e lidhën ndalimin me natyrën e veprës penale të kryer dhe jo me kushtet dhe rrethanat në të cilat ishte kryer. Prandaj, fakti që kërkuesi e kishte kryer veprën penale si i mitur nuk mund të konsiderohej një faktor lehtësues.

9. Kërkuesi paraqiti një ankesë kushtetuese. Më 23 mars 2023, Gjykata Kushtetuese, me pesë vota pro dhe një kundër, e rrëzoi ankesën e tij. Ajo deklaroi, në veçanti, se garantimi i integritetit të zyrtarëve publikë përbënte një qëllim legjitim për mbrojtjen e pavarësisë së shtetit, rendit demokratik dhe sigurisë kombëtare. Një ligj mund të kufizonte të drejtën për të ushtruar një profesion duke vendosur kritere të caktuara për të mbrojtur interesin publik. Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve kishte për qëllim garantimin e integritetit të kandidatëve për një karrierë si magjistrat (domethënë, një karrierë si gjyqtar ose prokuror). Interpretimi i tij nga gjykatat në rastin e kërkuesit nuk dukej arbitrar në kuptimin kushtetues. Prandaj, vendimet gjyqësore nuk kishin shkelur të drejtën e kërkuesit për të pasur akses në funksione publike. Për sa i përket shkeljes së pretenduar të së drejtës për jetë private, kërkuesi nuk kishte treguar se ndërhyrja ishte e rëndësishme. Përveç një karriere si magjistrat, atij nuk i ishte mohuar qasja në ndonjë funksion ose aktivitet tjetër publik që lidhet me një profesion që mund t'i siguronte atij jetesën përmes punës së ligjshme. Gjithashtu, kalimi i provimit për pranim në Shkollën e Magjistraturës ishte vetëm një hap drejt një karriere si magjistrat, e cila varej nga përfundimi me sukses i programit të formimit dhe procedurave të tjera ligjore që çonin në emërimin si magjistrat. Prandaj, ankesa e tij ishte e pabazuar. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese iu dorëzua kërkuesit më 26 prill 2023.

10. Gjyqtarja M. Xhaferllari shprehu një mendim mospajtues, duke kritikuar arsyetimin e gjykatave vendase nga perspektiva e së drejtës për një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në veçanti, ajo argumentoi se gjykatat e zakonshme kishin injoruar faktin se KLP-ja, në thelb, kishte zbatuar projekt-ndryshimet që qarkullonin në atë kohë, dhe se vetë Gjykata e Lartë kishte krijuar një qasje të prapaveprueshmërisë, duke zbatuar ligjin e ndryshuar pas vendimit të KLP-së. Ajo argumentoi më tej se shumica nuk kishte kryer një ushtrim të duhur balancimi midis interesave konkurruese dhe nuk kishte justifikuar pse ndalimi i pranimit të kërkuesit në Shkollën e Magjistraturës ishte proporcional dhe i pajtueshëm me dinjitetin njerëzor, duke pasur parasysh moshën e tij në kohën e veprës penale dhe aftësinë e kufizuar për të kuptuar seriozitetin dhe pasojat e veprimeve të tij.

Sipas saj, ishte e nevojshme të merreshin parasysh zhvillimet progresive në sistemin ligjor shqiptar në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, veçanërisht reformat e drejtësisë penale për të mitur të vitit 2017. Këto reforma synonin të siguronin që veprat penale dhe çdo dënim që rrjedh nga to nuk do të kishin pasoja të përjetshme për të miturit, që qasja në të dhënat personale të të miturve në konflikt me ligjin do të kufizohej ose edhe do të shkatërrohej, dhe që e drejta e tyre për jetë private do të merrte mbrojtje dhe garanci të veçanta. Gjykatat në rastin e kërkuesit nuk kishin shpjeguar nëse, dhe mbi çfarë baze, mund të supozohej se kërkuesi konsiderohej potencialisht i rrezikshëm ose nëse, në rast se pranohej si magjistrat, ai mund të vepronte në një mënyrë që mund të minonte besimin e publikut në integritetin profesional të magjistratëve.

11. Kërkuesi punoi si avokat në sektorin privat përpara se të shërbente, që nga viti 2019, si oficer i policisë gjyqësore në një prokurori.

II. DËNIMI I KËRKUESIT NË VITIN 2006

12. Më 21 nëntor 2006, kërkuesi u dënua për vjedhje (neni 134 i Kodit Penal) nga Gjykata e Rrethit Bulqizë dhe u dënua me tetë muaj burgim. U konstatua se në shtator 2006, gjatë një takimi midis babait të kërkuesit dhe tre personave të tjerë, përfshirë D., një blerës potencial i tokës që i përkiste babait, kërkuesi, në atë periudhë 15 vjeç, u la vetëm në makinën e D. ndërsa të rriturit inspektuan tokën. Në mungesë të tyre, kërkuesi hapi kroskotin e makinës, gjeti kartëmonedha me vlerë 1,000,400 lekë dhe i fshehu ato midis mbeturinave afërsisht dhjetë metra larg makinës. Kur u kthye, D. pa se kroskoti i makinës ishte hapur dhe se paratë mungonin. Kërkuesi fillimisht mohoi t'i kishte marrë paratë. D. telefonoi policinë. Kur u pyet në stacionin e policisë, kërkuesi pranoi se kishte marrë paratë, duke shpjeguar se ishte ndjerë në siklet që ta pranonte këtë gjë më herët përpara të tjerëve. Paratë u morën menjëherë dhe iu kthyen pronarit të tyre.

13. Në dhënien e dënimit, gjykata vuri në dukje se kërkuesi kishte pranuar fajësinë e tij, paraqiste një shkallë të ulët rreziku shoqëror dhe se pasojat e veprës penale ishin minimale, duke pasur parasysh që prona i ishte kthyer pronarit të saj, moshën e mitur të kërkuesit dhe nivelin e tij të arsimimit. Duke marrë, gjithashtu, parasysh nevojën që kërkuesi të vazhdonte shkollimin, gjykata pezulloi ekzekutimin e dënimit për tre vjet burgim sipas nenit 59 të Kodit Penal (shih paragrafin 18 më poshtë). Kërkuesi nuk bëri apel dhe vendimi mori formë të prerë më 1 dhjetor 2006.

KORNIZA DHE PRAKTIKA PËRKATËSE LIGJORE

I. LIGJI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME

A. Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe legjislacioni përkatës

14. Në periudhën konkrete, neni 28 i Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji nr. 96/2016) parashikonte, për sa ka të bëjë me çështjen, si në vijim:

"Neni 28

Kriteret e pranimit në formimin fillestar

Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t'u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

...

d) [ai se ajo] nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

...".

Neni 28(d), i ndryshuar me Ligjin nr. 50/2021 të datës 23 mars 2021, parashikon si në vijim:

"... [ai ose ajo] nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose prokurorit ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal.".

15. Mungesa e një dënimi përfundimtar për një krim përbën një nga kërkesat e përgjithshme për pranim në shërbimin civil në Shqipëri. Kjo vlen për pozicione të tilla si ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit (dhe, që nga ndryshimet në Ligjin për Gjyqësorin, më 23 mars 2021, ata që punojnë në gjykatat e shkallës së parë), këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Avokatë të Shtetit. Shkolla e Magjistraturës ofron formim fillestar profesional të detyrueshëm për kandidatët për këto pozicione (ligji nr. 152, i datës 30 maj 2013, ligji nr. 97, i datës 6 tetor 2016, ligji nr. 98, i datës 6 tetor 2016, ligji nr. 115, i datës 3 nëntor 2016 dhe ligji nr. 10018, i datës 13 nëntor 2008).

B. Ligji i Dekriminalizimit (2015)

16. Sipas neneve 2 deri në 5, të ligjit nr. 138/2015, për sigurimin e integritetit të personave që ushtrojnë,

zgjidhen ose emërohen në funksione publike (Ligji i Dekriminalizimit), i ndryshuar me ligjin nr. 38/2016, personat që dëshirojnë të emërohen në detyra publike duhet të plotësojnë dhe nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi që konfirmon se nuk ka arsye që pengojnë emërimin e tyre. Kjo përfshin mungesën e një dënimi penal të formës së prerë – qoftë në Shqipëri apo diku tjetër – që rezulton në një dënim me burgim për ndonjë nga veprat penale të listuara në Ligjin e Dekriminalizimit. Një deklaratë e rreme është e dënueshme sipas nenit 190 të Kodit Penal. Formulari standard i vetëdeklarimit përfshin pyetjen e mëposhtme: "A jeni dënuar ndonjëherë me një vendim gjyqësor të formës së prerë të një autoriteti gjyqësor shqiptar ose të huaj?".

17. Gjykata e Apelit Tiranë, në vendimin nr. 853, të datës 26 shtator 2022 (shih *Thanza kundër Shqipërisë*, nr. 41047/19, § 51, 4 korrik 2023), vendosi që dispozitat e Ligjit të Dekriminalizimit për zbulimin e të dhënave për vepra penale (shih paragrafin 16 më sipër) ishin në kundërshtim me rregullat e zakonshme të rehabilitimit sipas Kodit Penal dhe legjislacionit përkatës. Gjithashtu, formulari i vetëdeklarimit i lidhur me Ligjin e Dekriminalizimit, i cili u miratua përmes një "vendimi" të veçantë dhe atipik parlamentar (vendim), vendosi kërkesa për zbulim që shkonin përtej atyre të përcaktuara në vetë Ligjin e Dekriminalizimit dhe, deri në atë masë që, nuk mund të shkaktonin përgjegjësi penale (për deklarata të rreme) sipas nenit 190 § 1 të Kodit Penal. Vendimi i Gjykatës së Apelit u la në fuqi nga Gjykata e Lartë më 2 dhjetor 2025 (vendimi nr. 00-2025-1826).

C. Kodi Penal

18. Në periudhën konkrete, dispozitat përkatëse të Kodit Penal parashikonin si në vijim:

"Neni 59
Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim

Për shkak të rrezikshmërisë së ulët të autorit dhe rrethanave të veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet burgim, mund të urdhërojë që i dënuari të vendoset në shërbim prove, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së shërbimit të provës të mos kryejë vepër tjetër penale që është po aq e rëndë ose edhe më e rëndë sesa vepra penale fillestare.

Kohëzgjatja e afatit të shërbimit të provës është 18 muaj deri në 5 vjet.".

"Neni 62
Revokimi i shërbimit të provës

Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, kryen një vepër tjetër penale që është po aq e rëndë ose më e rëndë sesa vepra penale fillestare, gjykata do të revokojë vendimin për pezullim.

Revokimi ndodh edhe kur i dënuari, pa shkak të arsyeshëm, nuk përmbush masat dhe detyrimet… që i janë vendosur.

Kur vendimi për pezullim nuk revokohet, dënimi i dhënë do të konsiderohet i paqenë.".

Fjalia e fundit e nenit 62 u hoq si rezultat i ndryshimeve në Kodin Penal me anë të ligjit nr. 10023, të datës 27 nëntor 2008, që hyri në fuqi më 15 janar 2009.

"Neni 69
Rehabilitimi

Quhen të padënuar:

...

b) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet dhe që gjatë pesë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale.".

D. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

19. Dispozitat përkatëse të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (ligji nr. 37, i datës 30 mars 2017, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2018) parashikon si më poshtë:

"Neni 3
Përkufizime

...

3. I mitur është çdo person nën moshën 18 vjeç.

..."

"Neni 10
Parimi i interesit më të lartë të fëmijës

1. Organet kompetente në çdo vendim dhe veprimtari të ndërmarrë në zbatim të këtij Kodi, duhet të vlerësojnë me përparësi interesin më të lartë të të miturit.

…

3. Vendime dhe aktet e organeve kompetente duhet të përmbajnë një argumentim të posaçëm lidhur me mënyrën se si është analizuar dhe si do të sigurohet respektimi i interesit më të lartë të të miturit.".

"Neni 12
E drejta për zhvillim harmonik të të miturit

1. Në çdo vendim dhe procedurë lidhur me drejtësinë penale për të mitur mbahet në konsideratë e drejta e të miturit për zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

2. Vendimet dhe aktet e organeve kompetente duhet të përmbajnë një arsyetim të posaçëm lidhur me mënyrën se si është vlerësuar e drejta e të miturit për këtë zhvillim dhe si do të realizohet zbatimi i pikës 1 të këtij neni.".

"Neni 13
Parimi i proporcionalitetit

Çdo masë e marrë ndaj të miturit në konflikt me ligjin duhet të jetë në raport me rrethanat e kryerjes së veprës penale, personalitetin e të miturit, në përputhje me nevojat që lidhen me moshën, edukimin, arsimimin kushtet personale, familjare, sociale dhe mjedisore, nevojat zhvillimore, si dhe nevoja të tjera të të miturit përfshirë, nëse është rasti, edhe nevojat e veçanta.".

"Neni 14
Përparësia e masave alternative të shmangies

1. Për arritjen e qëllimeve të këtij Kodi dhe të ligjeve të tjera që kanë lidhje me drejtësinë për të mitur, në procedurën e drejtësisë penale për të mitur përparësi u jepet masave alternative të shmangies nga procedimi penal.

2. Masat alternative që synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese vlerësohen si mundësia e parë. Kur bëhet ky vlerësim, nga çdo organ kompetent, në aktet respektive pasqyrohet mbajtja në vëmendje që masa alternative e shmangies i shërben më mirë qëllimeve të rishoqërizimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit përkundrejt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit....".

"Neni 21
Mbrojtja e jetës private të të miturit

1. E drejta e të miturit për jetë private respektohet plotësisht në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur duke bërë kujdes që të shmanget dëmtimi i tij.

2. Nuk publikohet asnjë informacion që mund të çojë në identifikimin e të miturit në konflikt me ligjin, të të miturit viktimë ose dëshmitar i një vepre penale.

3. Të dhënat mbi dënimet e mëparshme të të miturit nuk bëhen publike.

4. Ndalohet identifikimi ose publikimi në çfarëdolloj forme i të dhënave personale të të miturit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat personale për një vepër penale të kryer nën moshën 18 vjeç mund të identifikohen ose të publikohen vetëm me pëlqimin e tij.

6. Përpunimi i të dhënave të të miturve realizohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Shkelja e pikës 4, të këtij neni, përbën vepër penale, sipas parashikimeve të Kodit Penal.".

"Neni 55
Kriteret dhe kushtet për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale

1. Organi kompetent në çdo rast vlerëson marrjen e masës së shmangies ndaj të miturit në konflikt me ligjin.

2. Organi kompetent, në marrjen e vendimit për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale vlerëson interesin më të lartë të të miturit, rëndësinë e veprës penale të kryer dhe dënimin e parashikuar për atë vepër, moshën e të miturit, shkallën e fajësisë, dëmin e shkaktuar, efektin frikësues të ndjekjes penale, sjelljen e të miturit pas kryerjes së veprës penale, si dhe raportin e vlerësimit individual, të hartuar sipas nenit 47 të këtij Kodi.

3. Në mënyrë të veçantë masa e shmangies nga organi kompetent zbatohet nëse:

a) ka prova të mjaftueshme për një dyshim të arsyeshëm se i mituri ka kryer një vepër penale, për të cilën parashikohet dënim me burgim deri në 5 vjet në maksimum ose me gjobë;

b) i mituri pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit;

c) i mituri nuk është kallëzuar për kryerjen e një vepre penale ose nuk është përsëritës;

...".

II. MATERIALI NDËRKOMBËTAR

A. Këshilli i Evropës

20. Rekomandimi nr. R (84) 10 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi të dhënat penale dhe rehabilitimin e personave të dënuar (i miratuar më 21 qershor 1984) vëren në preambulën e tij se çdo përdorim i të dhënave penale jashtë kontekstit të një gjykimi penal mund të rrezikojë shanset e një personi të dënuar për riintegrim shoqëror dhe për këtë arsye duhet të kufizohet "në maksimum". Rekomandimi i ftoi shtetet anëtare të rishikojnë legjislacionin e tyre, me qëllim futjen e një numri masash – duke përfshirë dispozita që kufizojnë komunikimin e informacionit të përmbajtur në regjistrat penalë dhe dispozita që rregullojnë rehabilitimin e shkelësve – që do të ndalonin çdo referencë ndaj dënimeve të një personi të rehabilituar përveç në baza bindëse të parashikuara nga ligji kombëtar.

21. Rekomandimi nr. R (87) 20 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi reagimet sociale ndaj shkeljeve të të miturve (i miratuar më 17 shtator 1987) shpreh, ndër të tjera, si më poshtë:

"Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës,

Duke marrë parasysh se të rinjtë janë qenie në zhvillim dhe si pasojë të gjitha masat e marra në lidhje me ta duhet të kenë karakter edukativ;

Duke marrë parasysh se reagimet sociale ndaj delikuencës së të miturve duhet të marrin parasysh personalitetin dhe nevojat specifike të të miturve, dhe se këta të fundit kanë nevojë për ndërhyrje të specializuara dhe, kur është e përshtatshme, trajtim të specializuar, bazuar në veçanti në parimet në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve;

I bindur se sistemi penal për të miturit duhet të vazhdojë të karakterizohet nga objektivi i tij i arsimit dhe integrimit social ...

...

Duke pasur parasysh Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit),

U rekomandon qeverive të shteteve anëtare të rishikojnë, nëse është e nevojshme, legjislacionin e tyre dhe praktikë me qëllim:

...

1. ndërmarrjen ose vazhdimin e përpjekjeve të veçanta për parandalimin e keqpërshtatjes dhe delinkuencës së të miturve, në veçanti:

a) duke zbatuar një politikë gjithëpërfshirëse që promovon integrimin shoqëror të të rinjve;

...".

22. Udhëzimet Evropiane mbi Etikën dhe Sjelljen për Prokurorët Publikë (Udhëzimet e Budapestit), të miratuara nga Konferenca e Këshillit të Evropës e Prokurorëve të Përgjithshëm të Evropës më 31 maj 2005, parashikojnë, ndër të tjera, si më poshtë:

"IV. Sjellja private

a) Prokurorët publikë nuk duhet të kompromentojnë integritetin, drejtësinë dhe paanshmërinë aktuale ose të perceptuar në mënyrë të arsyeshme të shërbimit të prokurorisë publike me anë të aktiviteteve në jetën e tyre private;

b) Prokurorët publikë duhet të respektojnë dhe t'i binden ligjit në çdo kohë;

c) Prokurorët publikë duhet të sillen në një mënyrë të tillë që të çojnë përpara dhe të ruajnë besimin e publikut në profesionin e tyre.

...".

23. Pjesa përkatëse e Opinionit nr. 13 (2018) mbi pavarësinë, llogaridhënien dhe etikën e prokurorëve, të lëshuar nga Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë (CCPE) i Këshillit të Evropës, parashikon si më poshtë:

"51. Respektimi i sundimit të ligjit kërkon standardet më të larta etike dhe profesionale në sjelljen e prokurorëve, si për gjyqtarët, si në detyrë ashtu edhe jashtë saj, gjë që lejon besim në drejtësi nga shoqëria. Prokurorët veprojnë në emër të popullit dhe për interesin publik. Prandaj, ata duhet të ruajnë, gjithmonë, integritetin personal dhe të veprojnë në përputhje me ligjin, në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe objektive, duke respektuar dhe mbështetur të drejtat dhe liritë themelore ...".

B. Kombet e Bashkuara

24. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, e datës 20 nëntor 1989, ku Shqipëria është një shtet palë, parashikon si më poshtë:

Neni 1

"Në këtë Konventë, me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.".

Neni 3 § 1

"Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.".

Neni 40 § 1

"Shtetet palë i njohin çdo fëmije të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës, si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj.".

25. Në Komentin e Përgjithshëm nr. 10 (2007), mbi të drejtat e fëmijëve në drejtësinë për të mitur (shih CRC/C/GC/10, 25 prill 2007), Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës theksoi se mbrojtjet e garantuara nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës në kontekstin e sistemit të drejtësisë penale zbatoheshin për të gjithë ata që ishin nën moshën 18 vjeç në kohën kur është kryer vepra penale. Ai vuri në dukje si më poshtë:

"29. Komiteti u kujton shteteve palë se, në përputhje me nenin 40 (1) të CRC-së, riintegrimi kërkon që të mos ndërmerren veprime që mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë të fëmijës në komunitetin e tij/saj, siç është stigmatizimi, izolimi social ose publiciteti negativ i fëmijës. Që një fëmijë në konflikt me ligjin të trajtohet në një mënyrë që nxit riintegrimin, kërkohet që të gjitha veprimet duhet ta mbështesin fëmijën të bëhet një anëtar i plotë dhe konstruktiv i shoqërisë së tij/saj.".

Komiteti trajtoi në mënyrë specifike çështjen e të dhënave penale për shkelësit e mitur, duke deklaruar si më poshtë:

"67. Komiteti, gjithashtu, rekomandon që shtetet palë të prezantojnë rregulla që do të lejonin heqjen automatike nga regjistrat penalë të emrit të fëmijës që ka kryer një vepër penale me mbushjen e moshës 18 vjeç, ose për disa vepra të kufizuara penale të rënda, ku heqja është e mundur me kërkesë të fëmijës, nëse është e nevojshme në kushte të caktuara (p.sh., të mos ketë kryer një vepër penale brenda dy viteve pas dënimit të fundit).".

Komiteti dha vërejtjet e mëposhtme, në lidhje me masat në sferën e drejtësisë për të mitur:

"71. ... që reagimi ndaj një vepre penale duhet të jetë gjithmonë në përpjesëtim jo vetëm me rrethanat dhe peshën e veprës penale, por edhe me moshën, fajësinë më të vogël, rrethanat dhe nevojat e fëmijës, si dhe me nevojat e ndryshme dhe veçanërisht afatgjata të shoqërisë. Një qasje rreptësisht ndëshkuese nuk është në përputhje me parimet kryesore për drejtësinë për të mitur të përcaktuara në nenin 40 § 1 të KDF-së [Konventa për të Drejtat e Fëmijëve] ... Në rastet e veprave të rënda penale të kryera nga fëmijët, mund të merren në konsideratë masa në përpjesëtim me rrethanat e autorit të veprës penale dhe peshën e veprës penale, duke përfshirë konsideratat e nevojës për siguri publike dhe sanksionet. Në rastin e fëmijëve, konsiderata të tilla duhet të tejkalohen gjithmonë nga nevoja për të mbrojtur mirëqenien dhe interesat më të mira të fëmijës dhe për të promovuar riintegrimin e tij/saj.".

LIGJI

I. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 8 TË KONVENTËS

26. Kërkuesi u ankua se vendimi për të mos e pranuar atë në Shkollën e Magjistraturës për formimin si prokuror për shkak të një dënimi të vuajtur për të mitur ka shkelur të drejtën e tij, në mbështetje të nenit 8 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

"1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose

moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.".

A. Pranueshmëria

27. Qeveria vuri në dukje punën e mëparshme të kërkuesit si avokat në sektorin privat dhe rolin e tij aktual si oficer i policisë gjyqësore në një prokurori, duke argumentuar se refuzimi i pranimit të tij në Shkollën e Magjistraturës nuk kishte arritur pragun e seriozitetit të kërkuar që të zbatohej neni 8. Sipas tyre, ai ende kishte të drejtë të punonte si avokat diku tjetër. Nëse ai do të ishte pranuar në programin trevjeçar të formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, shpërblimi i tij gjatë periudhës së formimit do të kishte qenë më i ulët se paga e tij si oficer i policisë gjyqësore.

28. Kërkuesi deklaroi se masa ishte zbatuar në bazë të një dënimi të kaluar si i mitur, në lidhje me një vepër penale të kryer në rininë e tij për shkak të papjekurisë. Kjo ia kishte bllokuar përgjithmonë dhe në mënyrë të pakthyeshme rrugën për t'u bërë magjistrat (konkretisht prokuror), një karrierë që ai e kishte ndjekur me përkushtim përmes arsimit ligjor, trajnimit, praktikës profesionale dhe pjesëmarrjes në procedurat konkurruese të përzgjedhjes për Shkollën e Magjistraturës, për të cilën ai ishte përgatitur dhe i kishte përmbushur të gjitha kriteret.

29. Gjykata përsërit se, ndërsa asnjë e drejtë e përgjithshme për punësim, as e drejta për akses në shërbimin civil apo e drejta për të zgjedhur një profesion të caktuar, nuk mund të nxirret nga neni 8, nocioni i "jetës private", si një term i gjerë, nuk përjashton në parim aktivitetet me natyrë profesionale ose biznesi. Në fund të fundit, është gjatë jetës së tyre të punës që shumica e njerëzve kanë një mundësi të konsiderueshme për të zhvilluar marrëdhënie me botën e jashtme (shih *Denisov kundër Ukrainës* [GC], nr. 76639/11, § 100, 25 shtator 2018). Kufizimet në jetën profesionale të një individi mund të jenë nën nenin 8, kur ato kanë pasoja në mënyrën se si ai ose ajo ndërton identitetin e tij ose të saj shoqëror duke zhvilluar marrëdhënie me të tjerët. Për më tepër, jeta profesionale shpesh është e lidhur ngushtë me jetën private, veçanërisht nëse faktorët që lidhen me jetën private, në kuptimin e ngushtë të termit, konsiderohen si kritere kualifikuese për një profesion të caktuar (shih *Pişkin kundër Turqisë*, nr. 33399/18, §§ 172–78, 15 dhjetor 2020, me referenca të mëtejshme, dhe *Özpınar kundër Turqisë*, nr. 20999/04, §§ 45–48, 19 tetor 2010). Për këtë arsye, jeta profesionale është pjesë e zonës së ndërveprimit midis një personi dhe të tjerëve, e cila, edhe në një kontekst publik, mund të jetë nën fushëveprimin e "jetës private" (shih *Fernández Martínez kundër Spanjës* [DHM], nr. 56030/07, §§ 109–10, GJEDNJ 2014 (fragmente)).

30. Ekzistojnë disa aspekte tipike të jetës private të cilat mund të preken në mosmarrëveshjet që lidhen me punësimin nga shkarkimi, ulja në detyrë, mospranimi në një profesion ose masa të tjera të ngjashme të pafavorshme. Këto aspekte përfshijnë: i. "rrethin e ngushtë" të kërkuesit; ii. mundësinë e kërkuesit për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me të tjerët; dhe iii. reputacionin shoqëror dhe profesional të kërkuesit. Ekzistojnë dy mënyra se si zakonisht do të lindte një çështje e jetës private në një mosmarrëveshje të tillë: ose për shkak të arsyeve themelore për masën e kontestuar (në këtë rast Gjykata përdor qasjen e bazuar në arsye) ose – në raste të caktuara – për shkak të pasojave për jetën private (në këtë rast Gjykata përdor qasjen e bazuar në pasoja). Megjithatë, kjo ndarje nuk përjashton rastet në të cilat Gjykata mund ta gjykojë të përshtatshme të përdorë të dyja qasjet në kombinim, duke shqyrtuar nëse ekziston një çështje e jetës private në arsyet themelore për masën e kontestuar dhe, përveç kësaj, duke analizuar pasojat e masës (shih *Denisov*, i cituar më sipër, §§ 115 dhe 109, dhe *Guliyev kundër Azerbajxhanit*, nr. 54588/13, § 43, 6 korrik 2023). Nëse është në rrezik qasja e bazuar në pasoja, pragu i ashpërsisë merr rëndësi vendimtare. Një prag i tillë duhet të vlerësohet duke krahasuar jetën e kërkuesit para dhe pas masës në fjalë, në mënyrë që perceptimet subjektive të kërkuesit të merren në konsideratë në kuadrin e rrethanave objektive që ekzistojnë në rastin e veçantë, si materiale ashtu edhe jomateriale (shih *Denisov*, i cituar më sipër, §§ 116–117).

31. Gjykata vlerëson se të dyja qasjet kanë lidhje me rastin aktual. Sa i përket arsyes për masën e kontestuar, ajo kishte të bënte me dënimin e kërkuesit 14 vjet para refuzimit të pranimit të tij në një program trajnimi që i mundësonte atij të ndiqte një karrierë si magjistrat (prokuror). Gjykata ka vendosur më parë se, ndërsa një dënim mbetet në të shkuarën, ai bëhet pjesë e jetës private të personit e cila duhet të respektohet (shih *M. M. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 24029/07, § 188, 13 nëntor 2012, dhe *Rotaru kundër Rumanisë* [DHM], nr. 28341/95, §§ 43–44, GJEDNJ 2000-V). Është e vërtetë që vetë kërkuesi zbuloi informacion, në

lidhje me dënimin e tij në aplikimin e tij në Shkollën e Magjistraturës dhe në vetëdeklarimin e kërkuar për procesin e verifikimit të pranimit, në të cilin iu kërkuan detaje mbi historinë e tij të dënimit dhe ai i dha ato sipas kërkesës. Kërkuesi ishte i detyruar të zbulonte të dhëna të tilla plotësisht dhe me vërtetësi, duke iu nënshtruar një dënimi për dëshmi të rreme, sipas formularit të vetëdeklarimit të kërkuar nga Ligji i Dekriminalizimit dhe, me sa duket, pavarësisht nga rehabilitimi i tij (shih paragrafin 16 më sipër). Kjo, në çdo rast, nuk e privon atë nga mbrojtja e ofruar nga Konventa (shih *M. M. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më sipër, § 189).

32. Gjithashtu, kërkuesi e kreu veprën penale në fjalë në moshën 15 vjeç, kur ai konsiderohej i mitur sipas ligjit vendas dhe si fëmijë sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve – të dyja termat nënkuptojnë një person nën 18 vjeç (shih paragrafët 19 dhe 24 më sipër). Për këtë arsye, duke pasur parasysh moshën e tij në kohën përkatëse, ai nuk mund të konsiderohej si person me aftësi për të parashikuar plotësisht pasojat e veprimeve të tij (shih, *mutatis mutandis, F. M. dhe të tjerë kundër Rusisë*, nr. 71671/16 dhe 40190/18, §§ 284, 181 dhe 175, 10 dhjetor 2024, në lidhje me aftësinë e fëmijëve për të dhënë pëlqimin).

33. Lidhur me pasojën e masës së kontestuar, ajo e pengoi përgjithmonë kërkuesin të ndiqte një karrierë si magjistrat, konkretisht si prokuror (shih, *mutatis mutandis, Farhad Mehdiyev kundër Azerbajxhanit*, nr. 36057/18, § 39, 18 mars 2025; krahaso dhe bëj dallimin në *Ballıktaş Bingöllü* kundër Turqisë, nr. 76730/12, § 60, 22 qershor 2021, dhe *Angerjärv dhe Greinoman kundër Estonisë*, nr. 16358/18 dhe 34964/18, § 125, 4 tetor 2022; krahaso dhe bëj dallimin edhe me *Bala kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 21141/20, §§ 60–66, 9 prill 2024, i cili kishte të bënte me aksesin në një numër të vogël pozicionesh të nivelit të lartë në sektorin e drejtësisë). Masa nënkuptonte, gjithashtu, se ai potencialisht ishte i ndaluar nga një gamë e tërë rrugësh karriere përtej asaj të prokurorit ose gjyqtarit, në veçanti pozicione si asistent ligjor, këshilltar ligjor në gjykatat e larta dhe Avokat i Shtetit, role për të cilat trajnimi në Shkollën e Magjistraturës i ofronte akses (shih paragrafin 15 më sipër).

34. Gjykata ka konstatuar se një kufizim në aksesin në pozicione që i shërbejnë interesit publik mund të ndikojë në gëzimin e së drejtës për respektimin e "jetës private" brenda interpretimit të nenit 8, për aq sa e pengon individin në fjalë të ndjekë një profesion që korrespondon me kualifikimet e tij ose të saj profesionale (shih *Naidin kundër Rumanisë*, nr. 38162/07, § 32, 21 tetor 2014, në të cilin neni 8 u gjet i zbatueshëm).

35. Në përgjithësi, gjatë shqyrtimit të rasteve të nenit 8 që kanë të bëjnë me profesionet juridike dhe profesione të tjera, Gjykata ka vendosur se kufizimet ligjore, në lidhje me personat e deklaruar të dështuar në ushtrimin e aktiviteteve të tyre profesionale dhe të drejtave civile, në veçanti për të mos u regjistruar si anëtarë të profesioneve të caktuara, siç është avokati ose noteri, preknin mundësitë e kërkueseve për të zhvilluar marrëdhënie me botën e jashtme dhe padyshim janë brenda sferës së jetës private, duke e bërë nenin 8 të zbatueshëm (shih *Campagnano kundër Italisë*, nr. 77955/01, § 54, GJEDNJ 2006-IV). Një ndalim i gjerë për punësimin në sektorin privat është konstatuar, gjithashtu, se ndikon në "jetën private" (shih *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, nr. 55480/00 dhe 59330/00, § 47, GJEDNJ 2004-VIII).

36. Bllokimi i aksesit në trajnim që çon në një rrugë të caktuar karriere mund të jetë, gjithashtu, brenda fushëveprimit të nenit 8. Në një rast të mëparshëm, Gjykata vendosi që vendimi për të hequr një kërkues nga një listë avokatësh praktikantë ndikoi në aftësinë e tij për të ndjekur aktivitetin e tij profesional dhe shkaktoi efekte pasuese në gëzimin e të drejtës së tij për respektimin e jetës së tij private sipas kuptimit të nenit 8 (shih *Jankauskas kundër Lituanisë* (nr. 2), nr. 50446/09, § 58, 27 qershor 2017). Në një rast tjetër, Gjykata vendosi që refuzimi për të lejuar një kërkuese të jepte provimin e avokatisë pas përfundimit të praktikës së saj si avokate ishte brenda fushëveprimit të nenit 8, sepse ndikoi në zgjedhjen e saj personale, në lidhje me mënyrën se si dëshironte të ndiqte jetën e saj profesionale dhe private (shih *Bigaeva kundër Greqisë*, nr. 26713/05, §§ 24 dhe 25, 28 maj 2009).

37. Në rastin konkret, refuzimi i pranimit të kërkuesit në Shkollën e Magjistraturës nuk lidhej me mungesën e kualifikimeve të kërkuara profesionale. Përkundrazi, ai ishte trajnuar dhe kishte punuar si avokat përpara se të bëhej oficer i policisë gjyqësore në një prokurori dhe kishte kaluar provimin e pranimit për formimin fillestar të magjistratëve. Arsyeja e vetme për ndalimin ishte dënimi i tij i mëparshëm për një vepër penale të kryer si i mitur, 14 vjet më parë – një dënim për të cilin ai ishte

rehabilituar ligjërisht dhe i cili ishte fshirë nga dosja e tij penale. Ndalimi absolut dhe i përhershëm i pranimit të tij në Shkollën e Magjistraturës, dhe rrjedhimisht i ndjekjes së një karriere si prokuror në një fazë të hershme të zhvillimit të tij profesional, pati një ndikim të qartë dhe serioz në zgjedhjen e tij personale, në lidhje me mënyrën se si ai dëshironte të ndiqte jetën e tij profesionale dhe private, të formonte identitetin e tij shoqëror dhe të zhvillonte marrëdhënie me të tjerët. Për këtë arsye, neni 8 është i zbatueshëm.

38. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është as haptazi e pabazuar dhe as e papranueshme për ndonjë arsye tjetër të listuar në nenin 35 të Konventës. Prandaj, ajo duhet të shpallet e pranueshme.

B. Meritat

1. Parashtrimet e palëve

39. Kërkuesi deklaroi se, në përputhje me nenin 62 të Kodit Penal (shih paragrafin 18 më sipër), dënimi i tij si i mitur ishte shuar plotësisht dhe konsiderohej se nuk kishte ekzistuar, dhe se, në çdo rast, ai ishte rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal (*ibid.*), me dënimin që ishte fshirë nga dosja e tij penale. Masa e kontestuar ishte arbitrare, stigmatizuese dhe ndëshkuese, e ngjashme me një dënim penal shtesë përtej kufijve të dënimit fillestar, dhe nuk mund të konsiderohej një pasojë e parashikueshme e veprimeve që ai kishte kryer si i mitur. Autoritetet vendase në thelb kishin zbatuar nenin e ndryshuar 28(d) të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në mënyrë retroaktive, duke demonstruar kështu cilësinë e mangët të ligjit vendas. Masa ishte një ndalim absolut i zbatuar automatikisht, pa asnjë vlerësim individual të rrethanave të tij specifike, siç është mungesa e ndonjë sjelljeje devijuese që nga vepra penale e kryer në rininë e tij për shkak të papjekurisë dhe, për rrjedhojë, mungesa e ndonjë rreziku për integritetin moral të sistemit të drejtësisë. Autoritetet vendase i kishin atribuuar dënimit të shuar një pasojë të përhershme ligjore, duke shpërfillur rëndësinë e rehabilitimit dhe riintegrimit të tij në shoqëri dhe duke shkelur të drejtat e tij për zhvillim personal dhe profesional dhe dinjitet njerëzor. Për më tepër, masa ishte në kundërshtim me zhvillimet e rëndësishme në të drejtën penale vendase, veçanërisht hyrjen në fuqi të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, sipas të cilit veprimet e kërkuesit të kryera si i mitur nuk do të ishin as subjekt i ndjekjes penale, e jo më të ndëshkoheshin dhe stigmatizoheshin përjetë me ndalimin për t'u bërë magjistrat. Në përputhje me standardet moderne, një sjellje e tillë do të adresohej përmes masave edukative dhe rehabilituese që synojnë riintegrimin. Sipas tij, pra, masa ishte e paligjshme dhe joproporcionale, dhe shteti kishte tejkaluar çdo kufi të arsyeshëm vlerësimi.

40. Qeveria deklaroi se, edhe duke supozuar se neni 8 ishte i zbatueshëm, ndërhyrja ishte në përputhje me ligjin vendas, i cili ishte i qartë dhe i parashikueshëm. Sa i përket domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit, ajo iu referua jurisprudencës së Gjykatës, në lidhje me rastet e verifikimit në Shqipëri (në veçanti, *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021), duke vënë në dukje se kriteret e rrepta të pranimit për gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm sipas Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve kishin qenë pjesë e reformës së ndërmarrë në vitin 2016, me qëllim rivendosjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Sipas qeverisë, dënimi i kërkuesit për vjedhje hidhte dyshime mbi integritetin e tij moral dhe marrëdhënien që ai do të kishte me detyrat e tij dhe ligjin, dhe krijonte baza për minimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Pozicioni i prokurorit përfaqësonte një nga funksionet më të ndjeshme në sistemin shtetëror, dhe për këtë arsye ishte e arsyeshme të kërkohej një standard më i lartë etik dhe moral për atë rol. Kufizimi në fjalë ishte në përputhje me rekomandimin nr. R (84) 10 të Komitetit të Ministrave (shih paragrafin 20 më sipër).

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Nëse ka pasur një "ndërhyrje"

41. Pasi ka konstatuar se neni 8 është i zbatueshëm (shih paragrafin 37 më sipër), Gjykata mban qëndrimin se refuzimi i pranimit të kërkuesit në Shkollën e Magjistraturës në bazë të një dënimi në të shkuarën si i mitur mund të konsiderohet një ndërhyrje në të drejtën e tij për respektimin e jetës së tij private. Për të përcaktuar nëse ndërhyrja përbënte shkelje të Konventës, Gjykata duhet të kërkojë të përcaktojë nëse ajo përmbushte kërkesat e nenit 8 § 2, domethënë nëse ishte "në përputhje me ligjin", ndiqte një qëllim legjitim sipas asaj dispozite dhe ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike" (shih *Pişkin*, cituar më sipër, § 203).

b) Nëse ndërhyrja ishte e justifikuar

i. Nëse ndërhyrja ishte "në përputhje me ligjin"

42. Formulimi "në përputhje me ligjin" kërkon që masa e kontestuar të ketë një bazë në ligjin e brendshëm. Ligji duhet të jetë i aksesueshëm për personin e interesuar dhe i parashikueshëm për sa i përket efekteve të tij (shih *S. dhe Marper kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 30562/04 dhe 30566/04, § 95, GJEDNJ 2008). Ndalimi i pranimit të kërkuesit në Shkollën e Magjistraturës bazohej në nenin 28(d) të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Për këtë arsye, Gjykata pranon se ndërhyrja kishte një bazë ligjore në ligjin e brendshëm.

43. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit se ligji vendas nuk përmbushte kërkesën e "cilësisë së ligjit", Gjykata vëren se, siç njihet nga gjykatat vendase, versioni i nenit 28(d) që ishte në fuqi në kohën kur masa e kontestuar u vendos kundër tij, nuk specifikonte se çfarë roli duhet të luante rehabilitimi në zbatimin e tij. Duke pasur parasysh parimin e përgjithshëm se individët nuk duhet të vazhdojnë të vuajnë pasojat e një dënimi pas rehabilitimit (shih nenin 69 të Kodit Penal në paragrafin 18 më sipër), konstatohet se kërkuesi kishte të drejtë të priste që dënimi i tij në të shkuarën në kohën e aplikimit në Shkollën e Magjistraturës nuk do të ishte pengesë për pranimin e tij.

44. Megjithatë, gjykatat vendase duket se kanë ndjekur logjikën e versionit të ri të nenit 28(d), ndryshuar në vitin 2021, ndërsa çështja e kërkuesit ishte në pritje të gjykimit para Gjykatës së Lartë, e cila i dha vetëm peshë të kufizuar rehabilitimit dhe i dha përparësi natyrës së veprës penale dhe ndikimit të saj në imazhin publik të magjistratëve, duke krijuar kështu përshtypjen e një zbatimi prapaveprues të asaj dispozite në rastin aktual.

45. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkuesi duhej të plotësonte dhe të dorëzonte një formular vetëdeklarimi sipas Ligjit të Dekriminalizimit, i cili kërkonte që kërkuesit për pozicione të ndryshme në sektorin publik të zbulonin historinë e tyre të plotë kriminale, edhe nëse ishin rehabilituar (shih paragrafët 16 dhe 17 më sipër). Ky aspekt shtoi konfuzionin, në lidhje me standardet ligjore të zbatueshme për kandidatët për pozicione magjistrate si kërkuesi.

46. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata ka dyshime nëse ligji përkatës ishte i parashikueshëm për kërkuesin. Megjithatë, në rrethanat e çështjes aktuale nuk është e nevojshme të thellohemi më tej në këtë çështje, sepse Gjykata vlerëson se, edhe duke supozuar se ndërhyrja ishte e ligjshme, ajo nuk ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike", për arsyet e detajuara më poshtë (shih paragrafët 48–59 më poshtë).

ii. Nëse ndërhyrja ndoqi një qëllim legjitim

47. Gjykata vëren arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese se ndalimi i pranimit të kërkuesit në Shkollën e Magjistraturës kishte për qëllim garantimin e integritetit të kandidatëve për karrierë si magjistrat për të mbrojtur pavarësinë e shtetit, rendin demokratik dhe sigurinë kombëtare (shih paragrafin 9 më sipër). Duke pasur parasysh edhe pretendimet e qeverisë se ndërhyrja ndoqi qëllimin e rivendosjes së besimit publik në sistemin e drejtësisë (shih paragrafin 40 më sipër), Gjykata pranon se ndërhyrja në të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës së tij private ndoqi qëllimet legjitime të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe të drejtave dhe lirive të të tjerëve sipas interpretimit të nenit 8 § 2 (shih *Xhoxhaj*, i cituar më sipër, §§ 391–93).

iii. Nëse ndërhyrja ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike"

α) Parime të përgjithshme

48. Për të përcaktuar nëse masa e kontestuar ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike", Gjykata duhet të shqyrtojë nëse, në rastin e çështjes në tërësi, arsyet e paraqitura për të justifikuar masën ishin relevante dhe të mjaftueshme, dhe nëse ajo ishte në proporcion me qëllimet legjitime të ndjekura (shih *Pişkin*, i cituar më sipër, § 212).

49. Në këtë kontekst, Gjykata përsërit rëndësinë themelore të detyrimit për të deklaruar arsyen për aktet administrative që prekin interesat individuale (shih, ndër autoritetet e fundit, *Versaci kundër Italisë*, nr. 3795/22, § 141, 15 maj 2025). Megjithatë, teksa u takon autoriteteve kombëtare të bëjnë vlerësimin fillestar të domosdoshmërisë, vlerësimi përfundimtar nëse arsyet e cituara për ndërhyrje janë relevante dhe të mjaftueshme mbetet subjekt i shqyrtimit nga Gjykata për përputhshmëri me kërkesat e Konventës. Gjykata duhet të sigurohet që autoritetet vendase kanë zbatuar standarde që ishin në përputhje me parimet e përfshira në Konventë dhe, për më tepër, se ato i kanë mbështetur vendimet e tyre në një vlerësim të pranueshëm të fakteve përkatëse. Lidhur me shqyrtimin e kryer nga gjykatat vendase, duhet theksuar se, teksa neni 8 nuk

përmban kërkesa të qarta procedurale, Gjykata nuk mund të vlerësojë në mënyrë të kënaqshme nëse arsyet e paraqitura nga autoritetet vendase për të justifikuar vendimet e tyre ishin "të mjaftueshme", për qëllimet e nenit 8 §2 pa përcaktuar në të njëjtën kohë nëse procesi i vendimmarrjes, i parë në tërësi, i siguroi kërkuesit mbrojtjen e nevojshme të interesave të tij, siç mbrohet nga ai nen (*ibid*., §§ 141–43).

50. Edhe pse në një kontekst të ndryshëm, Gjykata ka vendosur tashmë se autoritetet vendase mund të marrin në mënyrë legjitime masa që pengojnë individë të caktuar të ushtrojnë profesione të caktuara të ndjeshme, megjithatë me kusht që të përmbushen një numër kërkesash (shih *Opinionin këshillimor nëse një individi mund t'i mohohet autorizimi për të punuar si roje sigurie ose oficer për shkak të aftësisë ose përkatësisë së tij në një lëvizje fetare* [DHM], kërkesa nr. P16-2023-001, *Këshilli i Shtetit* i Belgjikës, §§ 84–85 dhe 92, 14 dhjetor 2023). Në veçanti, Gjykata ka vendosur se analiza e riskut që autoritetet vendase duhet të kryejnë, duhet të marrë parasysh natyrën e rolit specifik në fjalë (*ibid*., § 93), dhe se rreziku duhet të jetë subjekt i një vlerësimi individual dhe të detajuar të kryer sipas situatës personale të individit në fjalë (*ibid*., § 100), megjithëse pa shpërfillur plotësisht kontekstin e përgjithshëm (*ibid*., § 101). Gjykata ka sqaruar më tej se, pavarësisht nga natyra e së drejtës ose interesit që një masë parandaluese kërkon të mbrojë, duhet të ketë një rrezik real, me fjalë të tjera një rrezik që është i përcaktuar mjaftueshëm. Përmbajtja e një rreziku të thjeshtë spekulativ, i paraqitur si një masë parandaluese për mbrojtjen e demokracisë dhe vlerave të saj, nuk mund të shihet si përmbushje e një nevoje urgjente shoqërore. Që miratimi i masave parandaluese të jetë i ligjshëm, mund të jetë e nevojshme që autoritetet të bëjnë vlerësime specifike të shkallës së mundshme të pasojave që do të sillte përmbushja e rrezikut nëse nuk do të eliminohej në kohë. Përveç kësaj, rreziku që veprimi parandalues i autoriteteve kërkon të shmangë duhet të jetë serioz dhe madje të ketë një rëndësi të caktuar, pa të cilën çdo kufizim i të drejtave dhe lirive të të tjerëve mund të mos jetë i ligjshëm (*ibid*., §§ 103–04). Së fundmi, Gjykata ka vendosur se si vlerësimi i personalizuar i ekzistencës së një rreziku ashtu edhe vlerësimi i realitetit dhe shkallës së atij rreziku nga autoritetet përkatëse kombëtare duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit nga një autoritet gjyqësor i pavarur (*ibid*., §§ 101 dhe 105). Një autoritet i tillë duhet të jetë në gjendje të kryejë një shqyrtim efektiv të masës së kontestuar, dhe ky shqyrtim, për të përmbushur kërkesat e Konventës, duhet të ketë të bëjë me realitetin e rrezikut të identifikuar, shkallën e tij, natyrën dhe urgjencën e tij (*ibid*., § 112).

β) Zbatimi i parimeve të mësipërme në rastin aktual

51. Gjykata vëren se prokurorët, ashtu si gjyqtarët, duhet të përmbushin standarde të larta integriteti në kryerjen e detyrave të tyre profesionale dhe çështjeve të tyre private jashtë detyrës, me qëllim ruajtjen e besimit të publikut në integritetin e sistemit të drejtësisë (shih *Sevdari kundër Shqipërisë*, nr. 40662/19, § 95, 13 dhjetor 2022; shih, gjithashtu, Udhëzimet Evropiane mbi Etikën dhe Sjelljen për Prokurorët Publikë (Udhëzimet e Budapestit), dhe Opinionin pasues nr. 13 (2018) mbi pavarësinë, llogaridhënien dhe etikën e prokurorëve, të lëshuar nga Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë të Këshillit të Evropës, i cituar në paragrafët 22–23 më sipër). Mund të pranohet se për këtë qëllim shtetet mund të përcaktojnë rregulla të përgjithshme që kufizojnë aksesin në këto profesione për arsye integriteti. Megjithatë, Gjykata konsideron se në parim kërkohet një vlerësim i individualizuar, veçanërisht kur bëhet fjalë se sa të rënda janë veprat penale të të miturve (shih paragrafin 50 më sipër).

52. Lidhur me rastin aktual, Gjykata vëren, së pari, se arsyetimi në vendimet e autoriteteve vendase ishte në thelb i kufizuar mbi çështjen nëse duhej interpretuar neni përkatës i Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në një mënyrë që do të skualifikonte ata të rehabilituar pas një dënimi penal, pavarësisht mungesës së dispozitave të qarta për këtë qëllim. Qëndrimi i mbajtur ishte se rehabilitimi nuk duhet të merret për të hequr automatikisht efektin e nenit 28(d), dhe se faktori vendimtar që duhej vlerësuar ishte natyra e veprës penale, edhe nëse një person ishte rehabilituar. Sipas autoriteteve vendase, fakti që kërkuesi ishte i mitur në kohën përkatëse nuk mund të anashkalonte natyrën serioze të veprës penale.

53. Duke e kufizuar vlerësimin e tyre në këtë mënyrë, gjykatat vendase nuk ndërmorën një analizë të plotë dhe të individualizuar të rrethanave përkatëse për ndalimin e pranimit të kërkuesit në Shkollën e Magjistraturës dhe, rrjedhimisht, karrierën e një magjistrati. Prandaj, ato dështuan të kryenin ushtrimin e duhur të balancimit midis interesave konkurruese dhe të justifikonin pse

ndalimi i pranimit të tij në atë institucion ishte proporcional dhe i pajtueshëm me nocionin e respektimit të jetës private.

54. Së dyti, dhe më e rëndësishmja, Gjykata vëren se mosha e kërkuesit në kohën e veprës penale u konsiderua si pak e rëndësishme. E njëjta gjë vlente edhe për kohën e kaluar që nga vepra penale dhe sjelljen e tij gjatë asaj periudhe. Nuk pati diskutim mbi aspektin se sa e rëndë ishte vepra penale specifike e kryer nga kërkuesi, përveç një vërejtjeje të përgjithshme se vjedhja ishte një krim i rëndë i qëllimshëm. Në fakt, gjykatat vendase duket se kanë shpërfillur gjetjet e Gjykatës së Rrethit Bulqizë, e cila, duke dënuar kërkuesin në vitin 2006, vendosi se rrezikshmëria shoqërore dhe pasojat e veprës penale ishin minimale, duke pasur parasysh se prona i ishte kthyer pronarit të saj, moshën e kërkuesit dhe nivelin e tij të arsimimit në atë kohë. Duke marrë, gjithashtu, parasysh nevojën që kërkuesi të vazhdonte shkollën, gjykata pezulloi ekzekutimin e dënimit për tre vjet. Autoritetet vendase nuk morën në konsideratë as karakterin e kërkuesit në kohën e aplikimit të tij në Shkollën e Magjistraturës dhe nëse kishte ndonjë arsye për të besuar se, nëse pranohej në trajnimin e magjistratëve dhe i jepej mundësia për t'u bërë prokuror, ai do të sillej në një mënyrë që dëmton imazhin e një prokurori. Kjo pavarësisht faktit se kërkuesi më parë konsiderohej i përshtatshëm për të shërbyer si oficer investigativ brenda të njëjtit sistem prokurorial (shih paragrafin 11 më sipër).

55. Qasja e autoriteteve kombëtare bie ndesh me jurisprudencën e Gjykatës, në të cilën i është kushtuar vëmendje e veçantë moshës në rastet që përfshijnë ndërhyrje në jetën private. Në çështjen *Maslov*, për shembull, që kishte të bënte me dëbimin e një të huaji si rezultat i dënimeve për vepra penale të kryera midis moshës 14 dhe 15 vjeç, Dhoma e Madhe gjykoi se kur vlerësohet natyra dhe serioziteti i veprave penale të kryera nga një kërkues, duhet të merret parasysh nëse ai ose ajo i ka kryer ato si i mitur apo si i rritur (shih *Maslov kundër Austrisë* [DHM], nr. 1638/03, § 72, GJEDNJ 2008). Karakteristika vendimtare e atij rasti ishte mosha e re në të cilën kërkuesi kreu veprat penale dhe, me një përjashtim, natyra e tyre jo e dhunshme (*ibid.*, § 81). Kur arsyeja për ndërhyrje në jetën private të një personi qëndron në vepra penale të kryera kur ky person ishte i mitur, zbatohet detyrimi për të pasur parasysh interesat më të mira të fëmijës dhe përfshin një detyrim për të lehtësuar riintegrimin e tij ose të saj (*ibid.*, §§ 82–83). Detyrimi për të pasur parasysh interesat më të mira të fëmijës është i sanksionuar në nenin 3 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, ndërsa neni 40 e bën riintegrimin një qëllim që duhet ndjekur nga sistemi i drejtësisë për të mitur (*ibid.*; shih edhe paragrafët 24 dhe 25 më sipër). Të njëjtat parime u përfshinë në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur të Shqipërisë, i cili ishte në fuqi në kohën e masës së kontestuar kundër kërkuesit (shih paragrafin 19 më sipër).

56. Gjykata ka vendosur, gjithashtu, në një rast që ka të bëjë me përpunimin dhe zbulimin e të dhënave personale, në lidhje me dënimet penale dhe pasojat e tyre në jetën private të kërkuesve në një kontekst të ardhshëm punësimi, se niveli i ndërhyrjes në jetën private të personave të dënuar, dënimet e të cilëve janë shuar është veçanërisht ndërhyrës, në lidhje me riintegrimin e tyre shoqëror (shih *N. F. dhe të tjerë kundër Rusisë*, nr. 3537/15 dhe 8 të tjerë, § 54, 12 shtator 2023). Gjykata iu referua rekomandimit nr. R (84) 10 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, mbi të dhënat penale dhe rehabilitimin e personave të dënuar, sipas të cilit çdo përdorim i të dhënave penale jashtë kontekstit të një gjykimi penal mund të rrezikojë shanset e një personi të dënuar për riintegrim shoqëror dhe për këtë arsye duhet të kufizohet "në maksimum" (shih paragrafin 20 më sipër). Rekomandimi nr. R (87) 20 i Komitetit të Ministrave bëri thirrje më tej për zbatimin e një politike gjithëpërfshirëse që promovon integrimin shoqëror të të rinjve (shih paragrafin 21 më sipër).

57. Së fundmi, Gjykata përsërit se rehabilitimi, domethënë riintegrimi në shoqëri i një personi të dënuar, është i nevojshëm në çdo komunitet që ka vendosur dinjitetin njerëzor si pikën qendrore të tij (shih *Polyakova dhe të tjerë kundër Rusisë*, nr. 35090/09 dhe 3 të tjerë, § 88, 7 mars 2017, me referenca të mëtejshme, dhe *Danilevich kundër Rusisë*, nr. 31469/08, § 47, 19 tetor 2021). Gjykata vëren se legjislacioni përkatës kombëtar, dhe në veçanti Ligji i Dekriminalizimit (2015), duket se hesht mbi efektet e rehabilitimit, në lidhje me aksesin në një gamë të gjerë pozicionesh në sektorin publik.

58. Duke shpërfillur moshën e kërkuesit dhe duke trajtuar shkelësit e mitur dhe të rritur në mënyrë të barabartë, autoritetet shqiptare nuk i morën siç duhet parasysh konsideratat e mësipërme. Për më tepër, një sërë rrethanash nuk u morën në konsideratë mjaftueshëm, duke përfshirë natyrën jo

të dhunshme dhe impulsive të veprës penale të kryer nga kërkuesi, e cila mund të konsiderohet si një akt tipik i delinkuencës së të miturve (shih *Maslov*, i cituar më sipër, § 81, dhe, *a contrario*, me ndryshimet e nevojshme të bëra, *Azerkane kundër Holandës*, nr. 3138/16, § 73, 2 qershor 2020); kohëzgjatja që nga kryerja e veprës penale (shih, *mutatis mutandis*, *Hurbain kundër Belgjikës* [DHM], nr. 57292/16, § 221, 4 korrik 2023); sjellja e dukshme e kërkuesit që i bindej ligjit gjatë asaj periudhe, në të cilën ai u trajnua dhe punoi si avokat përpara se të bëhej oficer i policisë gjyqësore në një prokurori; dhe karakterin e tij në kohën përkatëse (shih, *mutatis mutandis*, *Maslov*, cituar më sipër, §§ 81–85 dhe 87–95; *İhsan Ay kundër Turqisë*, nr. 34288/04, § 40, 21 janar 2014; dhe *Gaughran kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 45245/15, § 94, 13 shkurt 2020). Masa e kontestuar u vendos në një fazë të hershme të jetës profesionale të kërkuesit dhe për këtë arsye pati një efekt të rëndësishëm në aspektin e kohëzgjatjes së saj (në kontrast me *Denisov*, cituar më sipër, § 128). Qasjes së autoriteteve vendase ndaj çështjes së kërkuesit i mungonte një vlerësim i plotë dhe mjaftueshëm i individualizuar i situatës së tij personale.

59. Duke pasur parasysh rrethanat e mësipërme, ndalimi i pranimit të kërkuesit në Shkollën e Magjistraturës për trajnim si prokuror në bazë të një dënimi për të mitur për të cilin ai ishte rehabilituar ishte joproporcional.

60. Në këtë mënyrë, është shkelur neni 8 i Konventës.

II. SHKELJE TË TJERA TË PRETENDUARA TË KONVENTËS

61. Kërkuesi u ankua se ishin shkelur të drejta e tij të mbrojtura sipas nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të mënyrës se si ishte zbatuar ligji vendas në procedurat në lidhje me vendimin për të mos e pranuar atë në Shkollën e Magjistraturës, si dhe e drejta e tij për arsim, sipas nenit 2, të Protokollit nr. 1 të Konventës. Megjithatë, duke pasur parasysh faktet e çështjes, parashtrimet e palëve dhe gjetjet e Gjykatës sipas nenit 8 të Konventës, Gjykata vlerëson se ka shqyrtuar çështjet kryesore ligjore të ngritura në kërkesën konkrete dhe se nuk ka nevojë të japë një vendim të veçantë për këto ankesa shtesë (shih *Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014).

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

62. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.".

A. Dëmi

63. Kërkuesi kërkoi një shumë të barabartë me pagën që do të kishte marrë nëse do të kishte ndjekur programin fillestar trevjeçar të formimit në Shkollën e Magjistraturës dhe më pas do të kishte punuar si magjistrat, si dhe çdo pagesë përkatëse të siguracioneve, interesin për inflacionin dhe taksat. Ai i kërkoi këto shuma deri në pikën ku do të mund të ndiqte programin e trajnimit ose deri në moshën e daljes në pension, të plotësuara nga pensioni përkatës, për sa i përket dëmit pasuror. Ai, gjithashtu, kërkoi 20,000 euro (EUR) në lidhje me dëmin jopasuror.

64. Qeveria parashtroi se kërkesa e kërkuesit, në lidhje me dëmin pasuror ishte e pabazuar, spekulative dhe e tepërt, pasi bazohej në një trajektore të mundshme karriere dhe jo në një humbje të provuar dhe të drejtpërdrejtë. Qeveria, gjithashtu, pretendoi se kërkesa në lidhje me dëmin jopasuror ishte e tepërt dhe e pambështetur në prova, dhe se vetëm gjetja e një shkeljeje nga Gjykata, nëse do të arrinte në një përfundim të tillë, do të përbënte dëmshpërblim të mjaftueshëm.

65. Gjykata nuk dallon ndonjë lidhje shkakësore midis shkeljes së gjetur dhe dëmit pasuror të pretenduar; prandaj e hedh poshtë këtë pretendim. Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se kërkuesi duhet të ketë pësuar dëm jopasuror si rezultat i shkeljes së gjetur. Duke bërë vlerësimin e saj mbi baza të drejta, ajo i jep atij 4,500 euro për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund të tarifohet.

66. Në fund, Gjykata vëren se ligji shqiptar parashikon mundësinë e rihapjes së procedurave gjyqësore në rastet kur Gjykata ka konstatuar shkelje të Konventës (shih *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, nr. 37474/20, §§ 56–57, 4 tetor 2022). Prandaj, forma më e përshtatshme e dëmshpërblimit për kërkuesin do të ishte rihapja e procedurave, nëse ai e kërkon këtë, dhe rishqyrtimi i çështjes në një mënyrë që është në përputhje me të gjitha kërkesat e nenit 8 të Konventës.

B. Shpenzimet dhe kostot

67. Kërkuesi kërkoi, gjithashtu, 5,000 euro "për çdo kosto, shpenzim, taksë ose detyrim tjetër bërë

përpara autoriteteve vendase" dhe Gjykatës. Ai nuk dha asnjë detaj dhe nuk paraqiti asnjë dokument mbështetës.

68. Qeveria parashtroi se kërkesa ishte e tepërt dhe e pambështetur në prova.

69. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një kërkues ka të drejtë për rimbursimin e kostove dhe shpenzimeve vetëm për aq sa është provuar se këto janë bërë në të vërtetë dhe sipas nevojës, dhe janë të arsyeshme për sa i përket sasisë. Në rastin konkret, duke marrë parasysh kërkesën e paraqitur nga kërkuesi dhe kriteret e mësipërme, Gjykata e hedh poshtë kërkesën për kosto dhe shpenzime.

për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

1. shpall të pranueshme ankesën sipas nenit 8 të Konventës, në lidhje me vendimin për të mos e pranuar kërkuesin në Shkollën e Magjistraturës për trajnim si prokuror për shkak të një dënimi të vuajtur si i mitur;

2. gjykon se është shkelur neni 8 i Konventës;

3. gjykon se nuk është e nevojshme të shqyrtohet pranueshmëria dhe themeli i ankesave të tjera sipas nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 2, të Protokollit nr. 1 të Konventës;

4. gjykon:

a) se shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuesit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet i formës së prerë, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 4,500 euro (katër mijë e pesëqind euro), që do të konvertohen në monedhën e shtetit të paditur me kursin e zbatueshëm në datën e shlyerjes, plus çdo taksë që mund të tarifohet, në lidhje me dëmin jopasuror;

b) se që nga përfundimi i tre muajve të lartpërmendur deri në shlyerje, mbi shumën e mësipërme do të paguhet interes i thjeshtë me një normë të barabartë me normën margjinale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes plus tre pikë përqindje;

5. rrëzon pjesën tjetër të pretendimit të kërkuesit për shpërblim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 10 mars 2026, në mbështetje të Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Ioannis Ktistakis
KRYETAR

Milan Blaško
REGJISTRAR

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 2053, datë 22.4.2026, vendosi shpalljen e vdekjes, më datë 8.2.2013, të shtetasit Petrit Çela, me atësi Zejnel dhe amësi Sulltane, i lindur më 2.5.1935, në Krujë.

KËRKESË

Shtetasi Gëzim Ajazi kërkon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpalljen e vdekjes së shtetasit Skënder Ajazi, me atësi Selman dhe amësi Xhemile, lindur më 24.4.1973, në Arrmoll, Dibër.

KËRKUES
Gëzim Ajazi

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 288 lekë

||FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË|Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 134|Datë: 25.06.2026 14:53:57 +02:00|e885595f-c62f-474e-9c05-44d4a8e4ae77

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë|të një procedure automatike nga një sistem elektronik|(Qendra e Botimeve Zyrtare)